



Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

ZGJEDHJET PRESIDENCIALE DHE ZGJEDHJET
E PARAKOHSHME PARLAMENTARE
13 dhe 27 prill 2014

Misioni i OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve
Raporti përfundimtar



Varshavë
15 korrik 2014

PËRMBAJTJA

I.	PËRMbledhje e shkurtër.....	1
II.	HYRJE DHE MIRËNJOHJET.....	3
III.	KONTEKSTI POLITIK.....	4
IV.	KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR.....	5
	A. KORNIZA LIGJORE	5
	B. SISTEMI ZGJEDHOR.....	7
V.	ADMINISTRIMI ZGJEDHOR.....	8
VI.	REGJISTRIMI I VOTUESVE.....	10
VII.	REGJISTRIMI I KANDIDATËVE.....	12
VIII.	FUSHATA ZGJEDHORE.....	13
IX.	FINANCIMI I FUSHATËS.....	16
X.	MEDIAT.....	17
	A. KLIMA MEDIATIKE	17
	B. KORNIZA JURIDIKE	18
	C. REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE.....	19
XI.	KUNDËRSHTIMET DHE PADITË.....	21
XII.	VËZHGESIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË.....	23
XIII.	DITA E ZGJEDHJEVE.....	23
	A. RRETHI I PARË.....	23
	B. RRETHI I DYTË.....	24
	C. SHPALLJA E REZULTATEVE.....	25
XIV.	KUNDËRSHTIMET DHE ANKESAT PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE.....	26
XV.	REKOMANDIMET.....	27
	A. REKOMANDIMET ME PRIORITET	27
	B. REKOMANDIMET TJERA.....	28
	RRETH OSBE/ODIHR-IT.....	32

**ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË
ZGJEDHJET PRESIDENCIALE DHE
ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE
13 dhe 27 prill 2014**

Raporti përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve¹

I. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

Me ftesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) e filloi Misionin për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ) për zgjedhjet presidenciale të datës 13 dhe 27 prill, si dhe për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 27 prillit. MVZ i OSBE/ODIHR-it e ka vlerësuar përputhshmërinë e procesit zgjedhor kundrejt përkushtimeve të OSBE-së dhe obligimeve tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe legjislacionit nacional. Për vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve më 13 prill, MVZ i OSBE/ODIHR-it i ka bashkuar forcat me delegacionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE). Për vëzhgimin në ditën e zgjedhjeve më 27 prill, MVZ i OSBE/ODIHR-it është shoqëruar edhe nga delegacionet nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së dhe nga PACE.

Si që ceket në dy Deklaratat e gjetjeve dhe përfundimeve preliminare, të cilat janë publikuar pas secilit rreth, zgjedhjet presidenciale dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare janë administruar në mënyrë efikase, përfshirë edhe ditën e zgjedhjeve. Kandidatët kanë pasur mundësi për ushtrim të papenguar të fushatës dhe është respektuar e drejta e tubimit dhe shoqërimit. Por, elementet e fushatës kanë treguar ndarje joadekuate të aktiviteteve partiake nga ato shtetërore, në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990, si dhe obligimeve tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Gjatë fushatës kanë vazhduar pohimet për frikësimin e votuesve, ndërkohë që partia qeverisëse e shqiptarëve etnikë i ka bërë thirrje votuesve etnikë shqiptarë të mos votojnë në zgjedhjet presidenciale, gjë që ka shkaktuar shqetësime për mundësinë e votuesve që të votojnë “të lire nga frika e hakmarrjes”, si që kërkohet me paragrafin 7.7 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.

Disa dispozita të Kodit Zgjedhor janë ndryshuar në janar të vitit 2014, duke trajtuar disa rekomandime paraprake të OSBE/ODIHR-it. Edhe pse nuk është praktikë e mirë të ndryshohen aspektet themelore të kornizës ligjore brenda një viti para zgjedhjeve, ndryshimet e fundit janë miratuar me konsensus ndërpartiak dhe pas konsultimit publik. Megjithatë, mbesin disa çështje të pavijueshmërisë dhe dykuptimësisë, përfshirë edhe mungesën e qartësisë në përkufizimin e fushatës, kohëzgjatjen e fushatës, keqpërdorimin e resurseve shtetërore gjatë fushatës, si dhe kufizimet e paarsyeshme të të drejtës për parashtrimin e kundërshtimeve. Më tej, kërkesa për dalje prej 40% në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale mund të rezultojë me cikle të zgjedhjeve të dështuara.

Presidenti zgjidhet drejtpërdrejtë nga votuesit, në sistem të shumicës. 120 deputetë janë zgjedhur sipas sistemit të përfaqësimit proporcional, si dhe 3 tjerë përmes sistemit të shumicës nga tre njësi zgjedhore jashtë vendit. Ndarja e pabarabartë e votuesve në njësitë jashtë vendit, si dhe

¹ Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar. Sigurohen përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

dallimi mes numrit të votuesve në njësitë brenda dhe jashtë vendit nuk e siguron në masë të plotë barazinë e votave, si që përcaktohet me Kushtetutë dhe me paragrafin 7.3 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) e ka respektuar shumicën e afateve ligjore dhe ka mbajtur sesione të rregullta, por ka vazhduar të jetë i ndarë përgjatë linjave partiake për të gjitha çështjet kontestuese politike. Për disa çështje, KSHZ nuk ka pasur komunikim efektiv me komisionet zgjedhore të nivelit më të ulët, duke shkaktuar konfuzion për disa procedura. Pavarësisht kësaj dhe mungesës fillestare të mjeteve të siguruara nga KSHZ, Komisionet komunale zgjedhore (KKZ) i kanë kryer detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe transparente.

Gjatë procesit zgjedhor, KSHZ ka dhënë disa udhëzime për ta rregulluar përputhjen e fushatës së dy zgjedhjeve. Ndërkohë që KSHZ është përgjegjës për qartësimin e aspekteve të legjislacionit zgjedhor, kompetencat e saj ligjore për ndryshimin efektiv të pjesëve kyçe të ligjit janë të diskutueshme.

Për këto zgjedhje ka pasur dy lista të ndara zgjedhore: 1.779.572 votues të regjistruar për zgjedhjet presidenciale dhe 1.780.128 votues për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Disa bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR-it kanë shprehur shqetësime të verifikuara lidhur me saktësinë e listës zgjedhore – veçanërisht mbi numrin e madh të votuesve të cilët banojnë në adresa të njëjta. Institucionet e shumta qeveritare të përfshira në krijimin e listës zgjedhore, përgjegjësitë e tyre të cilat përputhen dhe mungesa e bazës qendrore elektronike të të dhënave (ku agjencitë e ndryshme mund t'i azhurnojnë të dhënat), e bëjnë krijimin e listës zgjedhore të jetë gjë problematike dhe e komplikuar.

Regjistrimi i kandidatëve ka qenë përfshirës dhe i ka dhënë votuesve opsione të dallueshme. KSHZ ka regjistruar nëntë parti politike dhe pesë koalicione për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, si dhe katër kandidatë për zgjedhjet presidenciale. Megjithatë, kriteri i banimit për kandidatët presidencialë mund të konsiderohet si i tepërt dhe në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së dhe obligimet ndërkombëtare.

Janë respektuar masat ligjore për rritjen e pjesëmarrjes së femrave, përfshirë edhe kriterin e përfaqësimit me 30% në trupat e administrimit zgjedhor. Çdo vend i tretë në listat e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare ka qenë i rezervuar për gjininë me përfaqësim më të ulët. Prapëseparë, femrat nuk kanë qenë mjaft të përfaqësuara në tubimet e vëzhguara nga OSBE/ODIHR dhe çështjet gjinore nuk janë trajtuar në programet e fushatës.

Fushata ka qenë aktive me një numër të madh të tubimeve dhe posterëve. Të gjithë kandidatët kanë pasur mundësi për ushtrim të papenguar të fushatës. Avantazhi i dukshëm në resurse ka nënkuptuar që Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas qeverisëse dhe kandidati i saj presidencial kanë dominuar në dy fushatat. Ndërkohë që retorika e kandidatëve ka qenë më së shpeshti e moderuar, akuzat për korrupsion personal dhe rastet e gjuhës nxitëse e kanë zhvendosur fokusin nga çështjet konkrete dhe platformat partiake. Gjatë tërë fushatës kanë vazhduar pretendimet për frikësimin e votuesve nga partitë dhe autoritetet shtetërore.

Gjatë fushatës, partitë dhe kandidatët gjithmonë e më shumë i janë drejtuar bashkësive të tyre etnike. Një kandidat presidencial, maqedonas etnik i është drejtuar edhe bashkësisë etnike

shqiptare duke folur dhe duke i shfaqur materialet e promocionit zgjedhor edhe në gjuhën shqipe, gjatë ngjarjeve në zonat etnike shqiptare. Parimi i përfaqësimit të barabartë etnik në administratën zgjedhore është respektuar në të gjitha nivelet.

Korniza ligjore për financimin e fushatës ka siguruar kornizë të qartë për kontributet dhe shpenzimet e lejuara, si dhe për raportimin. Por, mbikëqyrja nga Enti Shtetëror për Revizion kufizohet në kontrollin e informatave të parashtruara nga garuesit në zgjedhje dhe Enti nuk ka mjete për të hetuar nëse informatat janë të sakta ose të plota. Me autorizime të pakta për sanksionim, kjo e pengon llogaridhënien e financimit të fushatës.

Ndonëse ka numër të madh të mediave, shumë bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR-it kanë pohuar që mediat janë nën kontroll indirekt nga partia qeverisëse, si pasojë e dominimit shtetëror në tregun e reklamave. Monitorimi i mediave nga MVZ i OSBE/ODIHR-it ka treguar që shumica e mediave të monitoruara kanë anuar dukshëm në favor të njëjës parti qeverisëse dhe kandidatit të saj presidencial, duke qenë kryesisht negative ndaj partisë opozitare dhe kandidatit të saj. Transmetuesi publik nuk ka siguruar mbulim të baraspeshuar dhe të barabartë për të gjithë kandidatët dhe partitë, duke e sfiduar kështu paragrafin 7.8 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990. Dështimi i mediave për ta bërë dallimin ndërmjet raportimit mbi zyrtarët shtetërorë në rolin e ministrave dhe si kandidatë, ka kontribuar në mos ndarjen e qartë të shtetit dhe partisë.

Mungesa e afateve gjyqësore për zgjidhjen e disa llojeve të lëndëve zgjedhore, e kombinuar me të drejtat e kufizuara të votuesve për ndreqjen ligjore në çdo fazë të procesit zgjedhor, nuk e garantojnë ndreqjen e plotë efektive, si që kërkohet me paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990. Më tej, ndaj disa vendimeve të trupave administrativë nuk mund të parashtrohet ankesë. Krejt kjo e bën joefektiv mekanizmin për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore.

Dy ditët e zgjedhjeve janë organizuar në mënyrë të papenguar, transparente dhe profesionale, ku janë vëzhguar vetëm parregullsi të kufizuara teknike. Këshillat zgjedhorë (KZ) kanë treguar njohuri të mirë të procedurave të votimit. Megjithatë, si pasojë e bojkotit të Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) në disa rajone etnike shqiptare, MVZ i OSBE/ODIHR-it ka vërejtur që anëtarët e KZ-ve i kanë dekurajuar votuesit nga marrja e fletëvotimit presidencial më 27 prill, me çka bëhet e diskutueshme paanshmëria e administratës zgjedhore. Rezultatet preliminare për dy rrethet zgjedhore janë shpallur në ueb-faqen e KSHZ-zë menjëherë pas pranimit, duke i ndarë rezultatet sipas komunave dhe vendvotimeve, që është një masë e rëndësishme e transparencës. Pas përfundimit të votimit më 27 prill, partia kryesore opozitare Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë ka shpallur që nuk do t'i njohë rezultatet e asnjërit proces zgjedhor dhe nuk do t'i pranojë mandatet parlamentare.

II. HYRJE DHE MIRËNJOHJET

Me ftesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) e filloi Misionin për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ) më 10 mars 2014 për zgjedhjet presidenciale të datës 13 dhe 27 prill, si dhe për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 27 prillit. MVZ është udhëhequr nga Ambasadori Geert-Hinrich

Ahrens dhe është përbërë nga 11 ekspertë të vendosur në Shkup, si dhe 20 vëzhgues afatgjatë në mbarë vendin. Anëtarët e Misionit kanë ardhur nga 17 shtete pjesëmarrëse të OSBE-së.

Për vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve më 13 prill, MVZ i OSBE/ODIHR-it i ka bashkuar forcat me delegacionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE), nën udhëheqjen e Stefan Schennach. Gjithsej, ka pasur 42 vëzhgues nga 23 shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, përfshirë edhe 27 vëzhgues afatgjatë dhe ekspertët e OSBE/ODIHR-it, si dhe 15 deputetë dhe personeli i PACE. Për shkak të mungesës së delegimit të vëzhguesve afatshkurtër, OSBE/ODIHR nuk ka pasur mundësi ta realizojë vëzhgimin e planifikuar të gjerë dhe sistematik të veprimeve në ditën e votimit të rrethit të parë zgjedhjeve presidenciale më 13 prill, përmes shpërndarjes së vëzhguesve afatshkurtër.

Për vëzhgimin e rrethit të dytë më 27 prill, MVZ i OSBE/ODIHR-it i ka bashkuar forcat me delegacionet e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, si dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE). Christine Muttonen është emëruar nga Kryesuesi i radhës i OSBE-së si Koordinatorë speciale për udhëheqjen e misionit afatshkurtër të vëzhgimit të OSBE-së. Isabel Santos e ka kryesuar delegacionin e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, ndërsa Stefan Schennach e ka udhëhequr delegacionin nga PACE. Gjithsej ka pasur 252 vëzhgues nga 32 Shtete pjesëmarrëse të OSBE/ODIHR-it, përfshirë 206 vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër të OSBE/ODIHR-it, si dhe 31 deputetë dhe personel shoqëruës nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së, si dhe 15 nga PACE.

MVZ i OSBE/ODIHR-it e ka vlerësuar përputhshmërinë e procesit zgjedhor kundrejt përkushtimeve të OSBE-së dhe obligimeve tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe kundrejt legjislacionit nacional. Ky raport përfundimtar vjen në vijim të Deklaratave të gjetjeve dhe përfundimeve preliminare, të publikuara pas dy ditëve zgjedhore gjatë konferencave për shtyp në Shkup, më 14 dhe 28 prill 2014.²

MVZ i OSBE/ODIHR-it dëshiron t'i falënderojë autoritetet për ftesën për vëzhgimin e zgjedhjeve, Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, Ministrinë e Punëve të Jashtme, autoritetet tjera shtetërore dhe lokale, partitë politike, mediat dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre. Misioni dëshiron t'i falënderohet edhe Misionit të OSBE-së në Shkup dhe përfaqësive diplomatike të shteteve-pjesëmarrëse të OSBE-së për bashkëpunimin dhe mbështetjen e treguar.

III. KONTEKSTI POLITIK

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë është republikë parlamentare, ku pushteti legjislativ i jepet parlamentit njëdhomësh prej 123 deputetëve, ndërsa pushteti ekzekutiv ushtrohet nga qeveria e udhëhequr nga kryeministri. Deputetët e parlamentit zgjidhen për mandat katërvjeçar. Presidenti është kreu i shtetit dhe zgjidhet drejtpërdrejtë për mandat pesëvjeçar.

Në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, zgjedhjet presidenciale të 13 prillit u shpallën më 1 shkurt, me rrethin e dytë të mundshëm të caktuar për 27 prill. Më vonë, parlamenti u

² Të gjitha raportet paraprake të OSBE/ODIHR për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë mund t'i gjeni në: <http://osce.org/odihr/elections/fyrom>.

shpërnda më 5 mars, me nismë të Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), me çka për herë të tretë të njëpasnjëshme u caktuan zgjedhjet e parakohshme parlamentare për më 27 prill, duke përkuar me rrethin e dytë të mundshëm të zgjedhjeve presidenciale.

Zgjedhjet paraprake parlamentare u realizuan më 5 qershor 2011 dhe rezultuan me qeveri të koalicionit ndërmjet Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partisë Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) me 56 deputetë, si dhe BDI-së së shqiptarëve etnikë me 15 mandate. Partitë opozitare në parlament e kanë përfshirë Lidhjen Socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM) me 42 mandate, Partinë Demokratike Shqiptare (PDSH) me 8, si dhe Rilindjen Demokratike Kombëtare me 2 mandate. 33% e deputeteve të parlamentit të shpërndarë kanë qenë femra.

Presidenti aktual Gjorge Ivanov, i ndërlidhur me VMRO-DPMNE-në ka garuar për mandat të dytë. Ai ka qenë i sfiduar nga Stevo Pendarovski, i ndërlidhur me LSDM-në opozitare; Iljaz Halimi, kandidati i vetëm etnik shqiptar, i ndërlidhur me Partinë Demokratike Shqiptare (PDSH); si dhe nga Zoran Popovski, i ndërlidhur me Opsionin qytetar për Maqedoninë (GROM) që është themeluar para ca kohësh.

BDI i ka bojkotuar dy rrethet zgjedhore të zgjedhjeve presidenciale dhe i ka bërë thirrje mbështetësve të saj që të mos votojnë, meqë partneri i saj i koalicionit VMRO-DPMNE nuk ka kandiduar një kandidat presidencial konsensual, i cili do t'i përfaqësojë dy bashkësitë – maqedonasit etnikë dhe shqiptarët etnikë.

IV. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

A. KORNIZA LIGJORE

Zgjedhjet përcaktohen nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, që është ndryshuar për here të fundit më 24 janar 2014 dhe i ka trajtuar disa rekomandime paraprake të OSBE/ODIHR-it. Edhe pse nuk është praktikë e mirë të ndryshohen elementet themelore të kornizës ligjore brenda më pak se një viti para zgjedhjeve,³ ndryshimet e fundit janë miratuar me konsensus ndërpartiak.⁴ Këto amendamente e kanë përfshirë futjen e disa masave mbrojtëse për ndarjen e partisë dhe shtetit, përfshirë edhe nisjen e projekteve qeveritare gjatë periudhës zgjedhore; qartësimin e dispozitave për financimin e partisë dhe fushatës; më shumë të drejta për partitë politike për shikimin dhe për të kërkuar ndryshime në listën zgjedhore; afate të ndryshuara për gjykatat për të vendosur mbi shkeljet e mediave, si dhe për përcjelljen e lëndëve në gjykata nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK).

Megjithatë, mbesin disa pavijueshmëri, zbrazëtira dhe mangësi pa trajtim nga ligji. Këtu përfshihet mungesa e qartësisë në përkufizimin e fushatës, kohëzgjatjen e fushatës, keqpërdorimin e resurseve shtetërore gjatë fushatës, kufizimet e paarsyeshme të të drejtës për parashtrimin e kundërshtimeve, si dhe mungesën e afateve dhe mundësive ligjore për

³ Komisionit i Këshillit të Evropës për demokraci përmes ligjit (Komisioni i Venedikut) në Pjesën II.2.b të Kodit të vitit 2002 të praktikës së mire të çështjeve zgjedhore, rekomandon që “elementet thelbësore të ligjit zgjedhor... nuk duhet të ndryshohen në periudhë më të shkurtër se një vit para zgjedhjeve”.

⁴ Amendamentet janë miratuar me 69 vota, përfshirë këtu ato nga VMRO-DPMNE, BDI dhe LSDM.

parashtrimin e disa llojeve të kundërshtimeve zgjedhore.⁵ Gjatë procesit zgjedhor, KSHZ ka dhënë disa udhëzime duke tentuar ta rregullojë fushatën e dy zgjedhjeve që janë përputhur, si dhe për disa çështje tjera.⁶ Për shembull, më 7 mars, KSHZ ka vendosur njëzëri për fillimin e fushatës parlamentare dy ditë para datës së caktuar me ligj, me ndërprerje dyditore gjatë heshtjes zgjedhore për zgjedhjet presidenciale. Ndërkohë që KSHZ ka qenë përgjegjës për qartësimin e aspekteve të legjislacionit zgjedhor, kompetencat e saj ligjore për ndryshimin efektiv të pjesëve kyçe të ligjit janë të diskutueshme.

Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet dhe t'i trajtojë zbrazëtitat dhe dykuptimësitë e identifikuar në këtë raport, si dhe në raportet paraprake të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venedikut. Reforma duhet të jetë inkluzive dhe të përmbyllet bukur para zgjedhjeve të ardhshme.

Më tej, garancitë ligjore për ndarjen ndërmjet partisë dhe shtetit mbeten të pamjaftueshme.⁷ Kërkesa ligjore për zyrtarët shtetërorë që të ushtrjnë vetëm detyra teknike gjatë veprimit si kandidatë është shfuqizuar përmes ndryshimeve të Kodit Zgjedhor të vitit 2014. Në një situatë ku pothuajse gjysma e të gjithë ministrave kanë garuar si kandidatë për partitë qeverisëse, kjo ka qenë një prapaktim nga parandalimi i keqpërdorimit të resurseve zyrtare dhe konflikteve të mundshme të interesit mes aktivitetëve zyrtarë të ministrave, si dhe roleve të tyre si kandidatë.

Si përjashtim, Neni 9 i Kodit Zgjedhor kërkon që “personat e autorizuar zyrtarë” në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministrinë e Mbrojtjes, t’i ndërpresin përkohësisht detyrat e tyre zyrtare pas konfirmimit si kandidatë.⁸ Kjo dispozitë e synon parandalimin e keqpërdorimit të resurseve zyrtare, si dhe evitimin e konfliktit të interesave që rrjedhin nga roli i dyfishtë i të qenit zyrtar në ndonjë ministri kyçe dhe kandidat gjatë periudhës zgjedhore. Dispozita në fjalë ka rëndësi të posaçme për Ministrën e brendshme, që ka pushtet mbi aspektet kyçe të procesit zgjedhor, përfshirë edhe krijimin e listës zgjedhore dhe hetimin e kundërvajtjeve zgjedhore. Pavarësisht kësaj dispozite, Ministrja e brendshme nuk është tërhequr nga pozita e saj në qeveri ndërkohë që ka garuar si kandidate

Garancitë ekzistuese ligjore në Kodin Zgjedhor duhet të interpretohen në mënyrë që i parandalon konfliktet e mundshme të interesit mes posteve qeveritare të cilat kërkojnë neutralitet, si dhe kandidatëve që kërkojnë avantazh politik nga ana tjetër. Dispozitat e këtylla duhet të zgjerohen për t’i përfshirë edhe mekanizmat e zbatimit.

⁵ Shikoni Mendimin e përbashkët të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venedikut mbi Kodin Zgjedhor të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 640/2011, CDL-AD(2011)027.

⁶ KSHZ gjithashtu i ka këshilluar votuesit që mund të votojnë për njërin ose dy proceset zgjedhore.

⁷ Paragrafi 5.4 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 e përcakton “ndarjen e qartë mes Shtetit dhe partive politike; në veçanti, partitë politike nuk mund të mishërohet me Shtetin”.

⁸ Neni 32 i Ligjit për punë të brendshme (2006) përcakton që “Ministri, Zëvendës-Ministri, Sekretari shtetëror, Drejtori i Byrosë së Sigurisë Publike, Drejtori i Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, si dhe të punësuarit tjerë në pozita udhëheqëse në MPB kanë status të personave të autorizuar zyrtarë”. Qeveria i është përgjigjur MVZ të OSBE/ODIHR-it që në kuptimin teknik, ministri nuk punon për ministrinë dhe së këndejmi, nuk i nënshtrohet këtij neni të Kodit Zgjedhor.

B. SISTEMI ZGJEDHOR

Presidenti zgjidhet drejtpërdrejtë nga votuesit, me sistem të shumicës. Person i njëjtë nuk mund të zgjidhet për këtë pozitë më tepër se dy herë. Për të qenë i zgjedhur në rrethin e parë, kandidati duhet ta fitojë shumicën e votave të të gjithë votuesve të regjistruar. Nëse asnjëri prej kandidatëve nuk e përmbush kushtin e cekur, brenda dy javëve mbahet rrethi i dytë mes dy kandidatëve të cilët kanë marrë më së shumti vota. Në rrethin e dytë fiton kandidati që e merr shumicën e votave, me kusht që dalja e votuesve të jetë mbi 40%. Përndryshe, përsëritet tërë procesi zgjedhor. OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venedikut e kanë kritikuar këtë kërkesë ligjore paraprakisht, meqë mund të rezultojë me cikle të zgjedhjeve të dështuara.⁹

Kërkesa për daljen e votuesve prej 40% në rrethin e dytë mund të rikonsiderohet dhe mënjanohet, meqë krijon mundësi për shkaktimin e cikleve të zgjedhjeve të dështuara.

Prej 123 deputetëve, 120 zgjidhen sipas sistemit të përfaqësimit proporcional në 6 njësi zgjedhore. Tre deputetët tjerë zgjidhen sipas sistemit të shumicës, në tre njësi jashtë vendit (ku përfaqësohen votuesit në Evropa dhe Afrika, Amerika veriore dhe jugore, Australia dhe Azia).¹⁰ Ndarja e pabarabartë e votuesve në njësitë jashtë vendit, si dhe mos barazia mes numrit të votuesve në njësitë brenda dhe jashtë vendit nuk e siguron në masë të plotë barazinë e votave, si që përcaktohet me Nenin 22 të Kushtetutës, si dhe paragrafin 7.3 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.¹¹ Ndërkohë që rrethanat speciale, përfshirë edhe faktorët gjeografikë, njihen si bazë e lejueshme për dallim nga barazia e votave, çdo devijim i mundshëm duhet të jetë minimal. Kodi Zgjedhor e lejon dallimin prej 5% mes njërive zgjedhore brenda vendit, por në kundërshtim me praktikën e mirë zgjedhore, njësitë jashtë vendit përjashtohen nga kërkesat e këtilla.¹²

Nevojitet rishqyrtimi i sistemit aktual të ndarjes së mandateve në njësitë zgjedhore jashtë vendit, për të siguruar që çdo deputet përfaqëson numër të ngjashëm të votuesve të regjistruar dhe për ta respektuar parimin e të drejtës së barabartë të votës.

⁹ Në Mendimin e përbashkët të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venedikut për Kodin Zgjedhor (2013), ceket që “pragu aktual i 50% të votuesve të regjistruar (dhe jo votave të hedhura) për të fituar në zgjedhjet presidenciale në rrethin e parë mbetet disproporcional dhe mund të shkaktojë rreth të dytë edhe nëse vetëm një kandidat i fiton të gjithë tjerët me dallim të madh. Ruajtja e kriterit për dalje të votuesve në rrethin e dytë (ku kërkohet shumica e votave me prag prej 40% të votuesve të regjistruar) mund të shkaktojë cikle të zgjedhjeve të dështuara”.

¹⁰ Në njësitë zgjedhore jashtë vendit, ka pasur 18,911 votues të regjistruar në njësinë zgjedhore 7 (Evropa dhe Afrika); në njësinë 8 (Amerika veriore dhe jugore) 3,337 votues të regjistruar, ndërsa njësia 9 (Australia dhe Azia) ka pasur 1,534 votues të regjistruar. Në njësitë zgjedhore brenda vendit, mesatarja e votave për çdo kandidat të zgjedhur ka qenë rreth 14,600.

¹¹ Paragrafi 7.3 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 parasheh që Shtetet-pjesëmarrëse duhet “ta garantojnë të drejtën universale dhe të barabartë të votimit për qytetarët e moshës madhore”. Më tej, në Mendimin e përbashkët të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venedikut (2011), ceket që “prezantimi i sistemeve të ndryshme zgjedhore për votimin jashtë vendit, krahasuar me atë në vend, nuk duket i arsyeshëm”.

¹² Komisioni i Venedikut në Pjesën I.2.2 të Kodit të praktikës së mire të çështjeve zgjedhore (2002), rekomandon që “mandatet duhet të ndahen në mënyrë të barabartë mes njërive zgjedhore... Dallimi i lejuar nga norma nuk duhet të jetë më shumë se 10% dhe gjithsesi nuk duhet të tejkalojë 15%, përveç rasteve të posaçme”.

V. ADMINISTRIMI ZGJEDHOR

Zgjedhjet presidenciale dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare janë administruar nga administrata zgjedhore në tre nivele: KSHZ, 80 Komisionet komunale zgjedhore (KKZ), 3.480 Këshillat zgjedhore (KZ) brenda vendit, si dhe 34 KZ në përfaqësitë diplomatike-konsullore (PDK) jashtë vendit. Janë respektuar dispozitat e Kodit Zgjedhor për përfaqësim të barabartë etnik dhe gjinor në administratën zgjedhore në të gjitha nivelet.¹³

KSHZ është trup i përhershëm përgjegjës për realizimin e përgjithshëm të zgjedhjeve. Përbëhet prej shtatë anëtarëve të emëruar nga parlamenti me shumicën e dy të tretave; anëtarët kanë mandat katërvjeçar.¹⁴ Kryetari dhe dy anëtarë propozohen nga partitë opozitare, ndërsa zëvendëskryetari dhe tre anëtarë nga partitë qeverisëse.

Në përgjithësi, sesionet e KSHZ-së kanë qenë të hapura për vëzhguesit e akredituar dhe mediat, me disa përjashtime.¹⁵ Procesverbalet e sesioneve janë publikuar në ueb-faqen e KSHZ-së brenda 48 orëve, sipas rekomandimit paraprak të OSBE/ODIHR. Megjithatë, në disa sesione është vërejtur mungesë e kolegjalitetit, ku anëtarët shpesh herë kanë bërë intervenime të gjata politike dhe kanë votuar përgjatë linjave partiake për kundërshtimet që kanë përfshirë çështje të diskutueshme politike – jo në bazë të cilësisë së rasteve.¹⁶ Kjo ka ndikuar negativisht në përgjegjësinë e anëtarëve të KSHZ-së për veprim të pavarur, si që kërkohet nga Neni 19(1) i Kodit Zgjedhor.

KSHZ duhet t'i zgjidhtë të gjitha kundërshtimet dhe ankesat me paanshmëri, duke qenë e lirë nga konsideratat politike. Ligji duhet të interpretohet, implementohet dhe zbatohet sipas qëllimit të ligjit dhe për më tepër, KSHZ duhet ta konsiderojë krijimin e një seksioni për çështje juridike, si që kërkohet me Kodin Zgjedhor.

KSHZ e ka përmbushur shumicën e afateve ligjore për përgatitjen e zgjedhjeve. Pavarësisht mbylljes së listës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare tetë ditë pas afatit ligjor, shtypja e fletëvotimeve dhe ekstrakteve të listave zgjedhore është përmbyllur me kohë. KSHZ është mbështetur nga sekretariati, të cilit duket se i kanë munguar resurset për menaxhimin e dy proceseve të ndryshme zgjedhore në të njëjtën kohë. Kjo është pasqyruar në problemet e komunikimit ndërmjet KSHZ-së dhe KKZ-ve mbi qartësinë e udhëzimeve të KSHZ-së, ku shumë KKZ e kanë informuar MVZ të OSBE/ODIHR-it që nuk i kanë pranuar me kohë përgjigjet e KSHZ-së ndaj pyetjeve të dërguara.

¹³ Sipas Nenit 21 të Kodit Zgjedhor, bashkësitë etnike të përfaqësuara me mbi 20% të popullatës në komunë duhet të përfaqësohen në KKZ-të dhe KZ-të, ndërsa të paktën 30% e anëtarëve në të gjitha trupat zgjedhorë duhet t'i takojnë gjinisë tjetër.

¹⁴ KSHZ-ja aktuale është emëruar më 26 prill 2011. Kryetari i ri i KSHZ-së është emëruar më 21 nëntor 2013 pas dorëheqjes së kryetarit të kaluar.

¹⁵ KSHZ ka mbajtur sesion pa paralajmërim më 30 mars, kur ka refuzuar 639 paraqitje për votim jashtë vendit. Nuk janë paralajmëruar as mbledhjet 79, 80, 81, 83, 85, 88, 94 dhe 98.

¹⁶ Mes çështjeve ndarëse të cilat janë diskutuar nga KSHZ kanë qenë edhe pranimi i simboleve partiake pranë emrit të kandidatëve presidencialë në fletëvotime, akuzat për fushatë të parakohshme; pohimet për ndërhyrjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme në KZ-të e PDK-ve, kërkesat nga MPB për konfirmimin e të dhënave nga listat zgjedhore, si dhe procedurat për regjistrimin e votuesve që votojnë në shtëpi.

Duhet të konsiderohet përforcimi i resurseve të sekretariatit të KSHZ-së, për ta siguruar kapacitetin e mjaftueshëm për realizimin e detyrave në mënyrë efikase.

KSHZ i ka dhënë udhëzime me shkrim KKZ-ve dhe KZ-ve për disa procedura, përfshirë edhe regjistrimin e votuesve në shtëpi, votuesit në arrest shtëpiak, votuesit me nevoja të posaçme, si dhe mbi detyrat e vëzhguesve të organizatave qytetare dhe procesin e kundërshtimeve. Disa prej këtyre udhëzimeve i kanë kufizuar ose kundërshtuar dispozitat e Kodit Zgjedhor.¹⁷

Fushata e KSHZ-së për edukimin e votuesve nuk ka siguruar informata për disa aspekte të rëndësishme të dy proceseve zgjedhore (ato presidenciale dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare). Në veçanti, fushata për edukimin e votuesve nuk i ka trajtuar në mënyrë adekuate rregullat e reja për mënyrën e paraqitjes për votim në shtëpi, as nuk i ka informuar votuesit që mund të zgjedhin nëse do të votojnë për dy zgjedhjet më 27 prill. OSBE/ODIHR ka rekomanduar më parë që KSHZ duhet të sigurojë më tepër informata për votuesit dhe edukim.

KKZ-të janë përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve në komunat gjegjëse, përfshirë edhe emërimin dhe trajnimin e KZ-ve dhe shpalljen e rezultateve zgjedhore në nivel komunal. KKZ-të përbëhen nga kryetari, katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre, me mandat pesëvjeçar. Anëtarët përzgjidhen nga KSHZ sipas zgjedhjes së rastit nga radhët e nëpunësve shtetërorë dhe lokalë, të cilët kanë diplomë universitare. Çdo KKZ ndihmohet nga sekretari dhe zëvendësi që i emëron kryetari i KKZ-së nga mesi i anëtarëve – juristë të diplomuar. Të gjithë anëtarët e KKZ-ve dhe zëvendësit e tyre duhet të banojnë në komunën gjegjëse. KSHZ ka realizuar dy sesione trajnuese për KKZ-të më 5 dhe 26 mars.

Shumica e KKZ-ve kanë pasur probleme financiare dhe KSHZ nuk i ka siguruar mjetet e nevojshme për administrimin e zgjedhjeve me kohë, që e ka shkaktuar situatën ku disa KKZ i kanë shpenzuar mjetet e tyre personale ose kanë funksionuar me huamarrje. Megjithatë, mungesa e mjeteve nuk e ka penguar përgatitjen e zgjedhjeve. Në pajtim me rekomandimet paraprake të OSBE/ODIHR-it, KKZ-të kanë organizuar trajnime të gjera për të gjitha KZ-të para rrethit të parë të zgjedhjeve presidenciale, si dhe një trajnim selektiv për kryetarët e KZ-ve para ditës së zgjedhjeve më 27 prill. MVZ i OSBE/ODIHR-it ka vlerësuar që KKZ-të kanë qenë me përvojë, profesionistë dhe transparentë.

Këshillat zgjedhorë (KZ) janë përgjegjës për realizimin e procedurave në ditën e zgjedhjeve në vendvotim. KZ-të krijohen sipas modelit të përzier profesional-politik, ku një anëtar propozohet nga partitë politike qeverisëse, një nga partitë opozitare dhe tre sipas zgjedhjes së rastit nga nëpunësit publikë. Në mënyrë të ngjashme janë formuar edhe KZ-të për vendvotimet në përfaqësitë diplomatike-konsullore (PDK) jashtë vendit, ku kryetari emërohet nga mesi i diplomatëve të punësuar në PDK-në gjegjëse. Kodi Zgjedhor është ndryshuar me dispozitën ku

¹⁷ Neni 111(1) i Kodit Zgjedhor përcakton që “votuesi i cili nuk është në gjendje të votojë (person i paaftë ose sëmurë)... duhet ta njoftojë KKZ-në, pa obligim për parashtrimin e dëshmisë mjekësore që personi ka ndonjë sëmundje të caktuar, për të aplikuar kështu”. Udhëzimi i KSHZ-së mbi regjistrimin e votuesve në shtëpi (27.02.2014) ka detajuar një listë të sëmundjeve të cilat janë të pranueshme për votuesit në shtëpi. Gjithashtu, votuesit është dashur t’i paraqesin dhe bashkëngjisin vërtetimet origjinale mjekësore ose dëshminë për përkujdesje shtëpiake. Një udhëzim tjetër i KSHZ-së e ka përkufizuar fletëvotimin si të pavlefshëm nëse shënohet me ndonjë stilograf me ngjyrë tjetër përveç ngjyrës së kaltër, që është në kundërshtim me Nenin 115 të Kodit Zgjedhor.

kërkohet që kryetarët e KZ-ve të kenë diplomë universitare, ndërsa anëtarët të kenë arsim të mesëm. Për disa KKZ, kjo ka shkaktuar vështirësi gjatë identifikimit të numrit të nevojshëm të personave të kualifikuar në fshatrat e vogla, por është vlerësuar që në përgjithësi, kjo dispozitë ka pasur ndikim pozitiv në punën e KZ-ve.

VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Në listën zgjedhore për votim në vend regjistrohen qytetarët me moshë të mbushur 18 vjeçare në ditën e zgjedhjeve, që kanë vendbanim në njësinë gjegjëse zgjedhore, kanë letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme biometrike dhe të cilëve nuk ju është marrë aftësia e veprimit juridik me vendim gjyqësor. Ndonëse Kushtetuta nuk kërkon që personi të ketë vendbanim në vend për të qenë votues, Kodi Zgjedhor përcakton që vetëm qytetarët me vendbanim në vend mund të përfshihen në listën zgjedhore. Disa prej bashkëbiseduesve të MVZ të OSBE/ODIHR-it kanë cekur që kërkesa për posedimin e letërnjoftimit ose pasaportës së vlefshme për të qenë i regjistruar është e paarsyeshme.¹⁸

Regjistrimi i votuesve është pasiv dhe KSHZ i mban listat zgjedhore në bazë të informatave nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), e cila i lëshon letërnjoftimet dhe pasaportat biometrike në bazë të regjistrave të shtetësisë dhe banimit. Kjo informatë i sigurohet KSHZ-së një ditë pas shpalljes së zgjedhjeve. Në ditën e njëjtë, gjykatat themelore ia dorëzojnë KSHZ-së të dhënat për qytetarët të cilët e kanë humbur aftësinë e veprimit juridik me vendim të plotfuqishëm gjyqësor. Më tej, Ministria e Drejtësisë ia siguron MPB-së informatat për personat të cilët kanë ndërruar jetë, që pastaj i përcillen KSHZ-së. Ndarja e listave zgjedhore sipas vendvotimeve bëhet nga Enti Shtetëror Statistikor (ESHS). Institucionet e shumta qeveritare të përfshira në krijimin e listës zgjedhore, përgjegjësitë e tyre të cilat përputhen dhe mungesa e bazës qendrore elektronike të të dhënave (në të cilat agjencitë e ndryshme mund t'i azhurnojnë të dhënat), e bëjnë krijimin e listës zgjedhore të jetë gjë problematike dhe e komplikuar.

Duhet të konsiderohet rishqyrtimi i procedurave të krijimit dhe mbajtjes së listave zgjedhore. Procedurat e qarta, të koordinuara dhe transparente për të gjitha institucionet e përfshira në azhurnimin e listave zgjedhore do ta rrisin saktësinë e tyre dhe mund të kontribuojnë në besimin publik.

Votuesit kanë pasur mundësi t'i shikojnë listat zgjedhore on-line ose në ndonjërin prej 34 zyrave rajonale të KSHZ-së, si dhe të kërkojnë plotësime, mënjanim ose ndryshime gjatë vitit, por jo më vonë se 10 ditë para ditës së zgjedhjeve.¹⁹ Meqë zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare janë shpallur në data të ndryshme, kanë dalluar edhe afatet për shikimin publik dhe mbylljen e listave zgjedhore për dry zgjedhjet.²⁰ Kjo ka rezultuar me dy lista të ndryshme

¹⁸ Paragrafi 11 i Komentit gjeneral nr. 25 i Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut (UNHCR) i vitit 1996 përcakton që "Shtetet duhet të ndërmarrin masa efektive për të siguruar që të gjithë personat me të drejtë vote kanë mundësi për realizimin e kësaj të drejte. Në rastet kur kërkohet regjistrimi i votuesve, ai duhet të lehtësohet dhe nuk duhet të imponohen pengesa ndaj regjistrimit të këtyre".

¹⁹ Rreth 73.400 persona e kanë kontrolluar regjistrimin e tyre në listën zgjedhore për zgjedhjet presidenciale, si dhe 11.544 për zgjedhjet parlamentare; shikimi i listës është bërë në degët e KSHZ-së.

²⁰ Afati ligjor për mbylljen e listës zgjedhore ka qenë më 22 mars për zgjedhjet presidenciale, ndërsa lista e zgjedhjeve parlamentare ka qenë me afat të mbylljes më 9 prill.

zgjedhore, ku për votim në zgjedhjet presidenciale janë regjistruar 1.779.572 qytetarë, ndërsa 1.780.128 për zgjedhjet e parakohshme parlamentare.

Listat zgjedhore për votim jashtë vendit janë krijuar në bazë të regjistrimit aktiv nga qytetarët të cilët kanë qenë të regjistruar në MPB si persona që përkohësisht banojnë ose punojnë jashtë vendit. Kjo dallon nga procedurat për votim në vend, ku kërkohet regjistrimi i votuesve. Prej rreth 83.500 qytetarëve të regjistruar në MPB si shtetas me banim ose punë të përkohshme jashtë vendit, janë regjistruar 8.332 për të votuar në zgjedhjet presidenciale, gjegjësisht 23.782 për zgjedhjet e parakohshme parlamentare.

Disa bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR-it e kanë ngritur çështjen e saktësisë së listave zgjedhore – veçanërisht lidhur me numrin e madh të votuesve të regjistruar në adresa të njëjta. BDI dhe LSDM kanë parashtruar kundërshtime në KSHZ për shlyerjen e votuesve nga lista zgjedhore, për të cilët kanë pohuar se janë regjistruar në adresa fiktive (*lexoni Kundërshtimet dhe paditë*).²¹ KSHZ ka kërkuar nga MPB – e cila i mban regjistrin e popullatës – t’i hetojë këto pretendime, por Ministria është prononcuar që nuk është përgjegjëse për verifikimin e pohimeve të këtilla. Mungesa e rregullave procedurale dhe institucionit konkret shtetëror për hetimin e kundërshtimeve ndaj listave zgjedhore, e pengon implementimin efektiv dhe besimin publik.

Kodi Zgjedhor duhet të rishqyrtohet për të siguruar ndarje të qartë të përgjegjësive mes MPB-së dhe KSHZ-së lidhur me kundërshtimet e listës zgjedhore. Autoritetet duhet të obligohen me ligj për hetimin e kundërshtimeve të këtilla brenda një afati të kuptueshëm kohor.

Sipas ligjit, personat me paaftësi ose që janë të sëmurë dhe që nuk mund t’i drejtohen vendvotimeve, mund të votojnë në shtëpi pasi që të paraqiten në KKZ. Sipas udhëzimit të lëshuar nga KSHZ, votuesit potencialë që do të votojnë në shtëpi është dashur të parashtrorjnë kërkesa zyrtare regjistrimi, së bashku me dokumentet mjekësore ose dëshminë për përkujdesje shtëpiake. Disa bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR-it kanë cekur që kjo ka qenë një pengesë e paarsyeshme për regjistrimin e votuesve me lëvizshmëri të kufizuar. MVZ i OSBE/ODIHR-it ka vërejtur pavijueshmëri në mënyrën në të cilën KKZ-të e kanë respektuar këtë udhëzim. Shumica e kërkesave i janë parashtruar KKZ-ve nga partitë politike, që kanë vepruar si ndërmjetësues. Votuesit në spitale që nuk kanë pasur mundësi udhëtimi drejt vendvotimeve kanë mund të votojnë vetëm nëse janë regjistruar paraprakisht si votues në shtëpi.

Së bashku me sigurimin e respektimit të kërkesave të rrepta për kualifikim për metodat alternative të votimit, duhet të konsiderohet thjeshtimi i procedurave për t’i mundësuar votuesve të cilët qëndrojnë në spitale, votuesve në shtëpi dhe tjerëve me lëvizshmëri të kufizuar për ta ushtruar të drejtën e tyre të votimit – pa pengesa të paarsyeshme.

²¹ Neni 49-a (2) i Kodit Zgjedhor parasheh që “brenda pesë ditëve nga pranimi i listës zgjedhore, partitë politike duhet t’ia parashtrorjë kërkesat KSHZ-së për regjistrimin, plotësimin ose shlyerjen e të dhënave”. Kodi Zgjedhor është i heshtur për llojin e dëshmimeve që duhet të prezantohet nga partitë politike, ndërkohë që KSHZ nuk ka fuqi ligjore për ta kontrolluar saktësinë e të dhënave të pranuar nga MPB. Për këtë arsye, në mungesë të informatave nga MPB, të gjitha ankesat e parashtruara sipas këtij neni janë refuzuar në bazë të mungesës së dëshmimeve.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

E drejta për kandidaturë presidenciale i jepet çdo qytetari me të drejtë vote, të cilët kanë të paktën 40 vjet moshe dhe që kanë jetuar në vend të paktën 10 vjet gjatë 15 viteve të fundit. Kjo kërkesë e periudhës së banimit mund të konsiderohet si e tepërt dhe jo proporcionale ndaj parimit të barazisë, që e sfidon Paragrafin 24 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990, si dhe obligimet tjera ndërkombëtare.²²

Rekomandohet mënjanimi i kërkesës së periudhës së banimit për kandidaturë presidenciale.

Propozimi për president është dashur të mbështetet nga 10.000 nënshkrime të votuesve të regjistruar ose 30 deputetëve. Nënshkrimet për mbështetje është dashur të mblidhen para përfaqësuesve të KSHZ-së në ndonjërin prej zyrave rajonale të saj.²³ Votuesi mund të nënshkruhet vetëm për një kandidat. Dy persona të propozuar, të cilët nuk i kanë mblledhur nënshkrimet e nevojshme, kanë pohuar se obligimi për dhënien e nënshkrimeve para zyrtarit shtetëror ka qenë frikësues dhe numri i nënshkrimeve të nevojshme ka qenë paarsyeshëm i lartë.²⁴ Asnjëri prej këtyre personave të propozuar nuk ka parashtruar kundërshtim zyrtar.²⁵

Mund të konsiderohet ofrimi i metodave alternative për mbledhjen e nënshkrimeve, për ta ulur potencialin për frikësim. Në vijim të rekomandimeve paraprake, mund të rishqyrtohet kufizimi që qytetarët të nënshkruhet për vetëm një kandidat.

KSHZ ka regjistruar katër kandidatë presidencialë. Ndonëse të gjithë katër kandidatët kanë vendosur të regjistrohen si kandidatë të pavarur, çdonjëri është mbështetur nga ndonjë parti politike dhe ka pranuar ndihmë gjatë fushatës, përfshirë edhe mjetet financiare. Përveç kësaj, KSHZ e ka aprovuar shfrytëzimin e simboleve partiake për çdo kandidat në fletëvotim.

Në zgjedhjet parlamentare mund të garojnë kandidatët e propozuar nga partitë politike, koalicionet e partive politike ose kandidatët e pavarur të propozuar nga grupe votuesish. Çdo qytetar me të drejtë vote ka pasur mundësi të garojë si kandidat në zgjedhjet parlamentare, përveç atyre që janë në kryerje të dënimit me burg prej të paktën 6 muajve për ndonjë veprë penale.

14 parti politike dhe koalicione kanë parashtruar lista të kandidatëve për zgjedhjet parlamentare. Të gjitha partitë etnike shqiptare kanë garuar veças, përfshirë BDI-në dhe Partinë Demokratike Shqiptare (PDSH). Vetëm BDI, LSDM dhe VMRO-DPMNE kanë parashtruar lista të kandidatëve në të gjitha njësitë zgjedhore. Në përgjithësi, regjistrimi i kandidatëve për zgjedhjet

²² Paragrafi 24 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 përcakton që kufizimet për të drejtat dhe liritë duhet të jenë “irreptësishtë proporcionale ndaj qëllimit të ligjit”. Më tej, paragrafi 15 i Komentit gjeneral nr. 25 i Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut (UNHCR) i vitit 1996 përcakton që “personat të cilët janë të përshtatshëm për kandidaturë zgjedhore nuk duhet të përjashtohen nga kërkesat e pakuptueshme ose diskriminuese, si që është arsimimi, banimi ose prejardhja, ose arsytet e përkatësisë politike”.

²³ Për ta shpejtuar procesin, KSHZ ka hapur zyra rajonale në 80 komuna.

²⁴ Komisioni i Venedikut në Pjesën I.1.3 të Kodit të praktikës së mire të çështjeve zgjedhore (2002), përcakton që “ligji nuk duhet të kërkojë mbledhje të nënshkrimeve për më tepër se 1% të trupit votues”.

²⁵ Stojanche Angelov, Kryetari i *Dostoinstvo (Dinjiteti)* dhe Biljana Vankovska, kandidate e pavarur

parlamentare ka qenë përfshirës dhe i ka mundësuar votuesve të kenë opsione të dallueshme. Ndonëse kjo mundësohet nga ligji, nuk është parashtruar asnjë listë e kandidatëve të pavarur. Në pajtim me kërkesat ligjore, çdo vend i tretë në listat e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare ka qenë i rezervuar për gjininë me përfaqësim më të ulët.

VIII. FUSHATA ZGJEDHORE

Fushata për zgjedhjet presidenciale ka filluar zyrtarisht më 24 mars dhe ka përfunduar në mesnatën e 11 prillit. Megjithatë, kandidatët i kanë filluar takimet me qytetarët edhe para kësaj date, duke ia prezantuar atyre platformat zgjedhore.²⁶ Ndonëse aktivitetet politike mund të realizohen edhe para fillimit zyrtar të fushatës, dispozitat e Kodit Zgjedhor lidhur me fushatën vlejné vetëm për aktivitetet e kandidatëve të konfirmuar gjatë periudhës së fushatës zyrtare.²⁷ Fushata për zgjedhjet e parakohshme parlamentare ka filluar më 5 prill, me ndërprerje dyditore gjatë heshtjes zgjedhore për zgjedhjet presidenciale.

Dispozitat mbi fushatën duhet të zbatohen në mënyrë që krijojnë mundësi të barabarta për garuesit.

Gjatë fushatës presidenciale, z. Ivanov dhe z. Pendarovski kanë pasur dukshmëri të lartë. Fushatën më pak e dukshme, z. Halimi dhe z. Popovski ia kanë përshtetur mungesës së resurseve financiare. BDI ka bërë fushatë me titullin “Jo presidentit të njëanshëm” për ta promovuar qëllimin e vet për një kandidat konsensual, si dhe për t’i bërë thirrje shqiptarëve etnikë që të përmbahen nga votimi në dy rrethet e zgjedhjeve presidenciale.²⁸

Dy fushatat kanë qenë aktive – billbordet dhe posterët kanë mbizotëruar në të gjitha qytetet më të mëdha. Kandidatët kanë pasur programe të ngjeshura të tubimeve, ku VMRO-DPMNE dhe LSDM, secila ka mbajtur tubime të përbashkëta për kandidatët presidencialë dhe parlamentarë.²⁹ Tubimet e vëzhguara nga MVZ i OSBE/ODIHR-it kanë rrjedhur pa pengesa dhe në përgjithësi me pjesëmarrje të mirë, ndonëse meshkujt kanë dominuar.³⁰ Të gjithë kandidatët kanë pasur

²⁶ Në mes të marsit, z. Ivanov vizitoi dhe bëri fushatë në disa qytete dhe fshatra. Më 23 mars, e ka prezantuar programin e tij zgjedhor. Më 16 mars, z. Pendarovski ka mbajtur një ngjarje zgjedhore me 50 persona në Prilep. Më 21 mars, PDSH ka mbajtur tubim me 350 njerëz në Gostivar për promovim dhe për t’i bërë thirrje shqiptarëve etnikë që ta votojnë z. Halimin.

²⁷ Sipas Nenit 2 (13) të Kodit Zgjedhor: “Fushatë zgjedhore është paraqitja publike e kandidatëve të verifikuar nga organet kompetente zgjedhore dhe programet e tyre në periudhën parazgjedhore për një lloj të caktuar të zgjedhjeve. Neni 69-a i Kodit Zgjedhor e përkufizon fushatën si “grumbullim publik dhe ngjarje tjera publike të organizuara nga ana e organizuesit të fushatës; shfaqja publike e afisheve, video-prezantimeve në vende publike, media zgjedhore dhe prezantimi në internet; shpërndarja e materialeve të shtypura dhe paraqitja e kandidatëve të konfirmuar nga organet kompetente zgjedhore dhe programet e tyre”.

²⁸ Lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, e ka inkurajuar vazhdimisht bashkësinë etnike shqiptare në fjalimet e fushatës që të mos votojnë, për ta parandaluar kështu përmbushjen e kërkesës për dalje prej 40% në rrethin e dytë, duke e shkakuar përsëritjen e zgjedhjeve. Më tej, dy organizata joqeveritare vendase, “Zgjuhu” (me seli në Shkup) dhe “Tradita” (me seli në Tetovë) kanë bërë fushatë ndaras duke i bërë thirrje shqiptarëve etnikë për bojkotimin e zgjedhjeve presidenciale.

²⁹ Ndërkohë që z. Pendarovski ka bërë fushatë të pavarur nga LSDM gjatë rrethit të parë të zgjedhjeve presidenciale, ai është shfaqur në tubimet e LSDM-së së bashku me udhëheqësit partiakë gjatë rrethit të dytë.

³⁰ MVZ i OSBE/ODIHR ka vëzhguar 142 tubime. Niveli mesatar i pjesëmarrjes së femrave në tubimet e

mundësi për ushtrim të papenguar të fushatës. Të gjitha partitë dhe koalicionet janë përqendruar në mbajtjen e ngjarjeve më të vogla dhe fushatës derë-më-derë, si mënyrë kryesore e komunikimit me votuesit. Partitë më të vogla dhe ato të reja në veçanti janë bazuar në këto metoda, meqë kanë pasur më pak mjete për organizimin e tubimeve të mëdha. Kandidatët i kanë shfrytëzuar edhe mediat sociale dhe ueb-faqet si vegla kyçe për komunikim me votuesit. Sa i përket fushatës parlamentare, materialet promocionale kanë qenë më të dukshme për liderët dhe bartësit e listave të koalicioneve dhe partive më të mëdha – VMRO-DPMNE, LSDM dhe BDI, ndërsa ka pasur më pak për PDSH, GROM, Rilindjen Demokratike Kombëtare (RDK) dhe Aleancën për Maqedoni Pozitive (AMP). Fushata për zgjedhjet presidenciale dhe ato parlamentare është dominuar nga VMRO-DPMNE, e cila ka pasur avantazh të dukshëm në aspektin e resurseve të fushatës.

Çështjet dhe prioritetet kryesore të kandidatëve për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare e kanë përfshirë zhvillimin ekonomik, punësimin e të rinjve, eliminimin e ndarjeve etnike, zgjidhjen e çështjes së emrit, si dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut. Dy partitë e koalicionit qeverisës (VMRO-DPMNE dhe BDI) i kanë shtuar apelet e tyre drejt bashkësive gjegjëse etnike për dhënien e numrit të nevojshëm të mandateve, me qëllim që ta përforcojnë pozitën e tyre dhe për ta evituar gjendjen ku do të duhet të bëjnë lëshime gjatë negociatave të ardhshme për krijimin e qeverisë.³¹ Megjithatë, z. Pendarovski është angazhuar drejt komunikimit me bashkësinë etnike shqiptare, duke folur pak shqip dhe duke i shfaqur materialet e promocionit zgjedhor edhe në gjuhën shqipe, gjatë ngjarjeve në zonat etnike shqiptare. Në programet e fushatës nuk janë ngritur çështjet gjinore.

Ndërkohë që gjuha e kandidatëve ka qenë më së shpeshti e moderuar, akuzat e vazhdueshme për korrupsion personal brenda blloqeve etnike e kanë zhvendosur fokusin nga çështjet konkrete dhe platformat partiake. Më tej, fjalimet në tubimet e PDSH-së kanë vazhduar të veçohen me gjuhë nxitëse kundër BDI-së, veçanërisht liderit të saj partiak. Me afrimin e ditës së zgjedhjeve më 27 prill, është rritur numri i rasteve të dëmtimit të zyrave zgjedhore.³²

Periudha e fushatës është hijesuar nga pretendimet e shumta dhe të vazhdueshme në mbarë vendin për frikësimin e votuesve dhe presionin nga autoritetet shtetërore. MVZ i OSBE/ODIHR-it ka pranuar disa pohime të besueshme, ku është përfshirë presioni për pjesëmarrje në ngjarjet e fushatës,³³ presioni për të mos marrë pjesë në ngjarjet e

vëzhguara nga vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it ka qenë rreth 27% (GROM 70%, VMRO-DPMNE 30%, Aleanca për Maqedoni Pozitive 28%, LSDM 26%, RDK 25%, BDI 13%, PDSH 6%).

³¹ Kryeministri i ka bërë thirrje të vazhdueshme maqedonasve etnikë që t'i japin partisë shumicë të qartë prej të paktën 62 mandateve, për të evituar çdo presion, ndikim ose kushtëzim nga partneri i saj i koalicionit, BDI. Në ndërkohë, BDI ka kërkuar nga mbështetësit e saj që të votojnë në numër sa më të madh në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, për t'i mundësuar partisë ta fitojë numrin maksimal të mandateve, me qëllim që ta përmirësojë pozitën në negociata.

³² Në polici janë raportuar këto dëmtime të zyrave: 4 të LSDM-së në Prilep, Negotinë, Makedonska Kamenica dhe Gjorçe Petrov; 3 të VMRO-DPMNE-së në Çair; 1 e GROM-it në Shkup; 1 e BDI-së në Prilep, si dhe një e Aleancës për Maqedoni Pozitive në Butel. Dëmtimi i zyrës së LSDM-së në Çair nuk është raportuar në polici.

³³ Në tubimin e organizuar nga GROM në Gjorçe Petrov më 8 prill, vëzhguesve afatgjatë të OSBE/ODIHR-it i janë afruar nëpunës shtetërorë, në kërkim të vendit ku duhet të nënshkruhet për prani. Një mësimdhënës në Gostivar ka raportuar që kolegëve ju është thënë nga eprori që të marrin pjesë në tubimin e BDI-së në Shkup, si dhe që kryetari i komunës i ka kërkuar listat e të pranishmëve në tubim.

kundërshtarëve,³⁴ si dhe premtimet ose kërcënimet për punësim në institucionet shtetërore – përfshirë edhe kontratat e përkohshme.³⁵ MVZ i OSBE/ODIHR-it ka vërejtur edhe pohime sipas të cilave aktivistët e partisë qeverisëse kanë kërkuar nga nëpunësit publikë të sigurojnë listë të votuesve të identifikuar të cilët do të votojnë për partinë qeverisëse (së bashku me numrat e tyre të identifikimit personal), duke i frikësuar edhe pronarët e bizneseve të vogla me kontrollë të inspektorëve tatimorë.³⁶ Kjo e ka ngritur çështjen e mundësisë së kandidatëve për fushatë në mjedis të drejtë, si dhe mundësinë e votuesve që të votojnë “të lire nga frika e hakmarrjes”, si që kërkohet me paragrafin 7.7 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.³⁷ Kjo lidhet edhe me mungesën e ndarjes mes fushatës partiake dhe aktiviteteve të Shtetit, si që ceket në paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.³⁸

Autoritetet duhet të tregojnë më tepër vullnet politik për ta siguruar ndarjen e mjaftueshme mes Shtetit dhe aktiviteteve partiake, si dhe të ndërmarrin hapa të fuqishëm për ndalimin e çfarëdo forme të presionit mbi votuesit. Zyrtarët e lartë publikë mund të japin deklarata të qarta dhe të lëshojnë instruksione me shkrim që nuk do të tolerohet asnjë presion mbi nëpunësit publike, si dhe që asnjë i punësuar ose qytetar nuk duhet të frikohet për vendin e punës ose për ndihmën sociale nëse mbështetë ose nuk mbështetë ndonjë parti politike ose kandidat të caktuar. Të gjitha rastet dhe pohimet e presionit dhe frikësimit duhet të hetohen dhe ndiqen detajisht nga institucionet kompetente.

MVZ i OSBE/ODIHR-it ka marrë pohime të besueshme për presionin e ushtruar nga aktivistët e BDI-së mbi votuesit etnikë shqiptarë, që të përmbahen nga votimi në zgjedhjet presidenciale – veçanërisht në rrethin e parë – si dhe kundër atyre të cilët kanë votuar në rrethin e parë, për të mos e marrë fletëvotimin presidencial më 27 prill.³⁹ MVZ i OSBE/ODIHR-it ka regjistruar edhe pohime të përsëritura dhe të besueshme që partitë e mëdha politike japin premtime ose kërcënime për ndërprerjen e përfitimeve të ndihmës sociale, si dhe për blerjen e votave mes grupeve me gjendje të vështirë ekonomike dhe grupeve të lëndueshme sociale (veçanërisht në bashkësinë rome dhe bashkësinë etnike turke).

³⁴ Vëzhguesit afatgjatë të OSBE/ODIHR-it janë informuar që nëpunësve publikë ju është ushtruar presion që të mos marrin pjesë në ngjarjet e fushatës së z. Pendarovski në Komunën Vallandovë .

³⁵ Një mësimdhënës në Gostivar i ka raportuar MVZ të OSBE/ODIHR-it që ka qenë e kërcënuar nga eprori që të tërhiqet nga kandidatura për RDK-në dhe të kalojë në BDI, në të kundërtën do ta humb vendin e punës. Përfaqësuesi i PDSH-së në Likovë i ka informuar vëzhguesit afatgjatë që ka qenë i zhvendosur nga vendi i punës (në sektorin publik), për qëllime politike, sipas pohimit të tij.

³⁶ MVZ i OSBE/ODIHR-it ka marrë shumë raporte, sipas të cilave policia nuk i ka hetuar pohimet e partive opozitare.

³⁷ Paragrafi 7.7 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 përcakton që “Shtetet-pjesëmarrëse duhet ta sigurojnë funksionimin e ligjit dhe politikës publike, në mënyrë që e lejon realizimin e fushatës politike në atmosferë të drejtë dhe të lirë... ose që i parandalon votuesit nga mësimi ose diskutimi mbi çështjet e cekura ose nga hedhja e votës së tyre – pa frikë nga hakmarrja”.

³⁸ Shikoni edhe Paragrafin I.3.1a të Kodit të praktikës së mire të çështjeve zgjedhore të Komisionit të Venedikut, ku ceket që “autoritetet shtetërore duhet ta respektojnë obligimin e tyre e të qenit neutral”.

³⁹ MVZ i OSBE/ODIHR-it ka marrë pohime të besueshme për presionin e BDI-së mbi votuesit etnikë shqiptarë në rrethin e parë, përfshirë edhe: praninë e mbështetësve të BDI-së më 13 prill para vendvotimeve duke i thënë njerëzve të mos votojnë, si dhe praninë e vëzhguesve të Asociacionit të qytetarëve për demokratizim dhe ngritje të vetëdijes publike (VEPRO) në vendvotime ku i fotografojnë dhe regjistrojnë ata që votojnë.

IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Financimi i fushatës rregullohet me Kodin Zgjedhor, si dhe me Ligjin për financimin e partive politike, me të cilat mundësohet një kombinim i financimit publik dhe privat të fushatës. Ndryshimet e kornizës juridike në janar të vitit 2014 kanë trajtuar disa prej rekomandimeve paraprake të OSBE/ODIHR-it, përfshirë përcaktimin e limitit të qartë për donacionet nga personat juridikë, si dhe kërkesën nga pjesëmarrësit në garën zgjedhore për parashtrim të raportit financiar një ditë para rrethit të dytë.⁴⁰

Pjesëmarrësit në zgjedhje obligohen ta regjistrojnë numrin e veçantë tatimor dhe të hapin llogari të posaçme bankare, ku duhet të qarkullojnë të gjitha transaksionet financiare të lidhura me fushatën. Individët mund të japin donacione deri në 5.000 EUR⁴¹ në kundërvlerë në valutën nacionale, ndërsa personat juridikë deri në 50.000 EUR.⁴² Mallrat dhe shërbimet që jepen me zbritje konsiderohen si donacione në natyrë dhe llogariten sipas çmimeve të tregut. Ndalohen donacionet anonime, si dhe ato që vijnë nga burimet publike ose të huaja, asociacionet qytetare dhe grupet fetare.

Limiti i shpenzimeve për çdo pjesëmarrës në zgjedhje është 3 EUR për çdo votues të regjistruar. Garuesit kompensohen me 0,25 EUR nga buxheti shtetëror për çdo votë të pranuar, me kusht që të kenë marrë të paktën 1.5% nga gjithsej votat e hedhura. Shpenzimet e fushatës që bëhen nga palët e treta, si që janë OJQ-të e lidhura me partitë nuk rregullohen dhe nuk i nënshtrohen raportimit ose mbikëqyrjes, duke ofruar kështu një zbrastëritje të mundshme për anashkalimin e rregullave për financim të fushatës.⁴³

Fushata nga palët e treta në procesin zgjedhor mund të jetë temë e legjislacionit për financimin e fushatës.

Garuesit zgjedhorë duhet të parashtrojnë dy raporte të përkohshme, si dhe një raport final për shpenzimet e fushatës, deri në KSHZ, Entin Shtetëror për Revizion (ESHR), si dhe Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK). Raportet e cekura publikohen, duke ndihmuar kështu në ngritjen e transparencës dhe duke i lejuar votuesve të bëjnë përzgjedhje të informuar para hedhjes së votës. Ndërkohë që Ministria e Financave ka siguruar një formular për raportim dhe i ka trajnuar partitë politike për plotësimin e formularëve para zgjedhjeve, formularët e rinj nuk kanë kërkuar që kandidatët t'i cekin shpenzimet sipas zërave në detaje. Pa kategorizimin e këtyre, kontrollimi i plotë i raporteve është i pamundshëm. Të gjitha raportet e përkohshme janë parashtruar nga garuesit dhe janë publikuar në institucionet gjegjëse me kohë.

⁴⁰ Shikoni edhe Raportin e dytë të përputhshmërisë (20.05.2014) të Grupit të shteteve kundër korrupsionit i Këshillit të Evropës (GRECO).

⁴¹ 1 EUR=61 MKD.

⁴² Paraprakisht, OSBE/ODIHR e ka rekomanduar rishqyrtimin e “mospërputhjes së natyrës së kufizimit për donacionet e fushatës, ndërmjet personave fizikë dhe atyre juridikë”.

⁴³ Shikoni Rekomandimin CM/Rec(2007)14 të Komitetit të Ministrave, drejtuar shteteve-anëtare për statusin ligjor të organizatave joqeveritare në Evropë (<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1194609>). Gjithashtu, Neni 7.3 i Konventës kundër korrupsionit të Kombeve të Bashkuara (2003), si dhe paragrafët 198-200 të Udhëzimeve të Komisionit të Venedikut dhe OSBE/ODIHR-it për rregullativën mbi partitë politike (2010).

Për ta rritur transparencën dhe llogaridhënien, mund të konsiderohet kategorizimi sipas zërave për të hyrat dhe të dalat në raportet e financimit të fushatës, së bashku me ekstraktet e plota bankare.

Raportet përfundimtare për financimin e fushatës parashtrihen brenda 30 ditëve pas zgjedhjeve dhe shqyrtohen nga ESHR brenda 60 ditëve nga parashtrimi. Mbikëqyrja e ESHR-së kufizohet në kontrollimin e informatave të parashtruara nga garuesit në zgjedhje – ESHR nuk ka mjete për të hetuar nëse informatat e dhëna janë të sakta ose jo.

Mund të konsiderohet që ESHR-së t'i jepet autorizim hetues, për ta mundësuar kontrollimin e plotë të financimit të fushatës, përfshirë edhe të drejtën për kërkimin e dokumentacionit plotësues dhe dëshmive nga partitë, me qëllim që të shqyrtohet çdo kundërvajtje e mundshme.

Nuk ka sanksione nëse nuk parashtrihen raportet financiare, ndonëse ESHR mund të kërkojë nga KSHZ që ta suspendojë kompensimin e shpenzimeve të pjesëmarrësve nga fondet shtetërore –pjesërisht ose tërësisht – në rast se gjejnë ndonjë parregullsi. ESHR mund të iniciojë edhe procedurë kundërvajtëse ose ta raportojë rastin në prokurori brenda 30 ditëve. Megjithatë, nuk ka afate kohore brenda të cilave gjykatat duhet të vendosin për këto shkelje. Më tej, palët e kyçura në zgjedhje nuk kanë të drejtë të parashtrijnë kundërshtime lidhur me shkeljet gjatë financimit të fushatës, që është në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.⁴⁴

Ligji duhet të parashoh sanksione proporcionale dhe shkëshillues për mosparashtrimin e raporteve për financimin e fushatës dhe kundërvajtjeve tjera.

X. MEDIAT

A. KLIMA MEDIATIKE

Mediat e shumta në vend janë të ndara përgjatë vijave etnike dhe politike. Televizioni është burimi kryesor i informimit politik në vend. Pesë stacione komerciale transmetohen në nivel nacional, dy prej të cilave (*Sitel* dhe *Kanal 5*) kanë pozita dominuese në tregun e reklamimit dhe e marrin shumicën e të hyrave të reklamave nga shteti. Transmetuesi publik, Radiotelevizioni Maqedonas (RTM) operon me tre kanale televizive në nivel nacional. RTM financohet përmes taksës së transmetimit, që paguhet nga amvisëritë dhe personat juridikë, por mund të kërkojë edhe mjete shtesë nga buxheti shtetëror, kurdo që mjetet ekzistuese janë të pamjaftueshme. Në vend funksionojnë tre radio stacione nacionale dhe tetë gazeta ditore në nivel nacional, ndërkohë që interneti shfrytëzohet shpesh si burim i informimit politik.

Shumë bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR-it e kanë shprehur shqetësimin mbi

⁴⁴ Paragrafët 232 dhe 233 të Udhëzimeve të Komisionit të Venedikut dhe OSBE/ODIHR-it për rregullativën mbi partitë politike (2010) përcaktojnë që “legjislacioni duhet të përcaktojë afate të arsyeshme brenda të cilave duhet të parashtrihen paraqitjet dhe të merren vendimet, duke i respektuar të gjitha konsideratat e veçanta që rrjedhin nga natyra subjektive e vendimeve... si dhe që “legjislacioni duhet t’i përcaktojë procedurat për inicimin e shqyrtimit gjyqësor (apelit) ndaj vendimit që i prek të drejtat e ndonjë partie politike. Legjislacioni gjithashtu duhet t’ia ofrojë të drejtën e shqyrtimit gjyqësor të vendimeve të këtylla edhe personave ose partive tjera, që preken nga vendimi në fjalë”.

pavarësinë e mediave, duke pohuar që mediat më të spikatura janë nën kontroll indirekt të partive qeverisëse, si pasojë e pozicionimit të shtetit si reklamuesi më i madh i vetëm. Palët tjera të kyçura në media gjithashtu kanë cekur që praktikohet auto-censura për të siguruar reklamim shtetëror, si dhe për t'i evituar paditë për shpifje.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA), e cila e ka zëvendësuar Këshillin për Radiodifuzion në vitin 2013, është trupi mbikëqyrës për mediat e transmetuara. Aktualisht, ASHMAA përbëhet prej 15 anëtarëve të mëparshëm të Këshillit për Radiodifuzion. Anëtarët e rinj është dashur të emërohen nga parlamenti, por procedura e emërimit është pezulluar për shkak të shpërndarjes së parlamentit. Shumica e anëtarëve të ASHMAA – përfshirë edhe kryesuesin – nuk kanë përvojë paraprake me mediat ose transmetimet. Mes bashkëbiseduesve të MVZ të OSBE/ODIHR-it, kjo e ka ngritur çështjen e kapacitetit profesional të ASHMAA-së për ushtrimin e ingjercave të saj.

Rekomandohet që anëtarët e ASHMAA-së të kenë përvojë paraprake me mediat dhe të mos jenë para se gjithash emërime politike.

B. KORNIZA JURIDIKE

Raportimi mbi fushatën zgjedhore nga mediat rregullohet me Kodin Zgjedhor, Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (2013), si dhe udhëzimet e ASHMAA-së. Kodi zgjedhor i obligon mediat e transmetuara t'i mbulojnë zgjedhjet në mënyrë të drejtë, të baraspeshuar dhe të paanshme. Gjatë fushatës zgjedhore, të gjithë kandidatët presidencialë kanë të drejtë të mbulimit të barabartë, ndërsa pjesëmarrësit zgjedhorë në garën parlamentare duhet të mbulohen në mënyrë proporcionale, duke u bazuar në numrin e listave të regjistruara të kandidatëve. Më tej, Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale i obligon të gjithë transmetuesit që të sigurojnë raportim objektiv dhe të paanshëm, me trajtim të barabartë të vështrimeve dhe mendimeve të ndryshme.

Kodi Zgjedhor përcakton kërkesa të detajuara për edicionet informative të RTM-së gjatë fushatës zgjedhore: një e treta e edicionit informativ duhet t'i përkushtohet ngjarjeve lokale dhe ndërkombëtare, një e treta për aktivitetet e partive politike qeverisëse, ndërsa një e treta për aktivitetet e partive në opozitë.⁴⁵ Koha që i ndahet partive qeverisëse dhe atyre opozitare bazohet në rezultatet e zgjedhjeve të fundit parlamentare. Mbulimi në edicionet informative gjatë periudhës zgjedhore nuk i takon edhe partive politike që nuk përfaqësohen në parlament, që është në kundërshtim me Paragrafin 7.8 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.⁴⁶ Në bazë të rekomandimit të ASHMAA-së, RTM i ka dhënë kohë shtesë partive joparlamentare dhe partive etnike shqiptare në edicionet informative.

Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet për t'i dhënë të gjithë pjesëmarrësve zgjedhorë qasje pa diskriminim në transmetuesin publik.

⁴⁵ Sipas ligjit, mosrespektimi i këtyre rregullave nga RTM mund të rezultojë me shkarkimin nga detyra e Drejtorit gjeneral të RTM-së.

⁴⁶ Paragrafi 7.8 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 përcakton që “asnjë pengesë administrative ose ligjore nuk duhet ta pengojë qasjen e papenguar ndaj mediave – pa diskriminim për të gjitha grupet politike dhe individët të cilët kanë dëshirë të marrin pjesë në procesin zgjedhor”.

RTM-së nuk i lejohet shitja e reklamave të paguara politike, por obligohet të jep hapësirë për transmetim politik pa pagesë. Korniza ligjore nuk e trajton kohëzgjatjen e kohës së dhënë dhe periudhën kur duhet të transmetohet ajo. Për këto zgjedhje, RTM ka vendosur t'i jep nga 10 minuta secilës parti parlamentare, si dhe nga 15 minuta secilit kandidat presidencial para rrethit të parë të zgjedhjeve presidenciale. Duke qenë në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, RTM nuk i ka siguruar kandidatëve presidencialë kohë transmetimi pa pagesë për rrethin e dytë zgjedhor. ASHMAA obligohet t'i monitorojë mediat e transmetuara gjatë fushatës dhe të reagojë ndaj parregullsive. Rezultatet e monitorimit të ASHMAA-së për rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale kanë identifikuar mungesë të dukshme të baraspeshës sasiore tek *TV Sitel*. Megjithatë, ASHMAA ka vendosur të mos shqiptojë sanksione deri në publikimin e raportit të saj final, ku është përfshirë tërë periudha e fushatës për dy proceset zgjedhore. Kjo nuk është në pajtim me Kodin Zgjedhor, ku obligohet ASHMAA të iniciojë procedura të kundërvajtjes brenda tre ditëve nga konstatimi i kundërvajtjes dhe njëherazi, nuk siguron ndreqje efektive si që parashihet me Paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.⁴⁷

ASHMAA ka identifikuar gjithsej 29 kundërvajtje ku përfshihen 17 media, kryesisht lidhur me emetimin e reklamave të paguara dhe anketave, si dhe fushatës gjatë heshtjes parazgjedhore. Shumica e kundërvajtjeve janë zgjidhur përmes shqiptimit të gjobave para procesit gjyqësor.

ASHMAA duhet të iniciojë procedura kundërvajtëse lidhur me shkeljet e identifikuar me kohë, për ta rritur besimin publik dhe për t'i siguruar ndreqje efektive palëve të cilat kundërshtojnë. Sanksionet duhet të definohen qartë dhe të përkasin me peshën e shkeljes.

C. REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE

MVZ i OSBE/ODIHR-it i ka monitoruar transmetuesit dhe mediat kryesore të shtypura gjatë dy fushatave.⁴⁸ Ndërkohë që të gjitha mediat e monitoruara kanë siguruar mbulim të gjerë të fushatës në edicionet informative, shumica me përjashtim të *Telma* dhe *Vesti 24*, kanë treguar anshmëri të dukshme në favor të partive qeverisëse – në aspekt sasior dhe tonit të raportimit.

Ndërkohë që RTM i ka përmbushur kërkesat ekzakte sasiore për raportim mbi partitë politike dhe koalicionet, toni i raportimit ka dalluar. Të gjithë pjesëmarrësit janë mbuluar në mënyrë kryesisht neutrale, përveç BDI-së, VMRO-DPMNE-së dhe z. Ivanov, që kanë fituar mbulim pozitiv duke i theksuar të arriturat dhe projektet e ardhshme. Çdo lajm negativ për partinë VMRO-DPMNE dhe kandidatin e mbështetur kryesisht është shpërfillur.⁴⁹ Një debat me të gjithë katër kandidatët presidencialë është organizuar nga RTM-1. Edhe Instituti Nacional

⁴⁷ Paragrafi 5.10 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 përcakton që “të gjithë duhet të kenë të drejtë të mjeteve efektive të ndreqjes kundër vendimeve administrative, për ta garantuar respektimin e të drejtave themelore dhe për ta siguruar integritetin ligjor”.

⁴⁸ MVZ i OSBE/ODIHR-it ka realizuar monitorim të mediave në periudhën 11 mars deri më 25 prill. Monitorimi i e ka përfshirë periudhën para fushatës dhe dy rrethet zgjedhore të zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare. MVZ i OSBE/ODIHR-it e ka monitoruar raportimin mbi fushatën nga *RTM-1*, *RTM-2*, *Sitel*, *Kanal 5*, *Alfa*, *Telma* dhe *Alsat-M gjatë kohës me shikueshmëri më të lartë* (18:00 deri 24:00), si dhe dy edicioneve kryesore informative të *Vesti 24* (20:00 dhe 22:00). Përveç kësaj, MVZ i OSBE/ODIHR-it e ka monitoruar edhe raportimin mbi fushatën në pesë gazeta ditore: *Dnevnik*, *Sloboden Pecat*, *Nova Makedonia*, *Koha* dhe *Lajm*.

⁴⁹ *RTM-1* ka pasur qasje të ngjashme edhe kur ka raportuar për konferencat për shtyp të MVZ të OSBE/ODIHR-it, kur janë prezantuar vetëm përfundimet pozitive të Deklaratës së gjetjeve dhe përfundimeve preliminare, duke i anashkaluar të gjitha vërejtjet kritike.

Demokratik (NDI) ka organizuar disa debate presidenciale dhe parlamentare, por z. Ivanov dhe VMRO-DPMNE kanë vendosur të mos marrin pjesë.⁵⁰

Televizionet private *Kanal 5 dhe Sitel* i kanë kushtuar 46-51% të raportimit kryesisht pozitiv ose neutral aktivitetëve të VMRO-DPMNE-së dhe z. Ivanov në edicionet informative. Për dallim nga kjo, për LSDM-në dhe z. Pendarovski ka pasur 30-34% të raportimit, kryesisht me ton negativ. Gjatë fushatës për rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, *Alfa* i ka kushtuar raportim të ngjashëm z. Ivanov dhe z. Pendarovski; megjithatë, ndërkohë që toni i raportimit për z. Ivanov ka qenë kryesisht pozitiv ose neutral, për z. Pendarovski toni ka qenë kryesisht negativ ose neutral.

Gjatë fushatës së zgjedhjeve parlamentare, *Alfa* i ka kushtuar VMRO-DPMNE-së rreth 50% të raportimit lidhur me zgjedhjet, kryesisht me ton pozitiv. Për dallim nga kjo, LSDM-së i janë dhënë 27% të mbulimit kryesisht negativ. Televizionet private *Telma* dhe *Vesti 24* kanë pasur mbulim më të baraspeshuar të fushatës, duke i kushtuar proporcione të ngjashme të raportimit VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së, si dhe kandidatëve të tyre. Ndërkohë që toni i raportimit ka qenë kryesisht neutral në *Vesti 24*, *Telma* ka treguar qasje kritike në raportimin për qeverinë dhe VMRO-DPMNE-në. *Alsat-M* ka raportuar për fushatën kryesisht në mënyrë neutrale, por i ka dhënë më tepër kohë raportimi BDI-së.

Monitorimi i mediave nga MVZ i OSBE/ODIHR-it ka identifikuar disa raportime kundër LSDM-së, të transmetuara nga *Sitel*, *Kanal 5* dhe *Alfa* me përmbajtje shumë të ngjashme, duke iu referuar burimeve të paidentifikuara ose anonime. *RTM*, *Sitel*, *Kanal 5* dhe *Alfa* gjithashtu i kanë kushtuar mbulim të konsiderueshëm aktivitetëve të ministrave të cilët kanë garuar si kandidatë – shpesh në mënyrë pozitive, duke mos e bërë dallimin mes raportimit për këta zyrtarë si ministra dhe si kandidatë.

Mediat e transmetuara – veçanërisht ato publike – duhet të bëjnë më shumë përpjekje për ta bërë dallimin e qartë mes aktivitetëve zyrtarë qeveritare të kandidatëve dhe shfaqjeve në fushatë, nga ana tjetër.

Transmetuesit privatë kanë të drejtë të shesin deri në 12 minuta në orë për reklama të paguara politike, ku maksimumi për një garues zgjedhor është 8 minuta brenda një ore. LSDM dhe Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Popullore (VMRO-PP) i janë ankuar MVZ të OSBE/ODIHR-it që kur kanë tentuar të blejnë hapësirë reklamuese në *Sitel* dhe *Kanal 5*, ju është thënë që pjesa më e madhe e hapësirës në dispozicion ka qenë e blerë nga garuesit tjerë. Monitorimi i realizuar nga MVZ i OSBE/ODIHR-it ka treguar që gjatë dy fushatave zgjedhore, në të gjithë transmetuesit privatë të monitoruar, rreth 62 orë e reklamimit të paguar politik është blerë nga VMRO-DPMNE dhe kandidati i saj presidencial, rreth 12.5 orë nga GROM dhe kandidati i saj presidencial, 6.5 orë nga BDI, 5.5 orë nga LSDM dhe kandidati i saj presidencial, si dhe 2 orë nga VMRO-PP.

Krahasuar me mediat e transmetuara, ato të shtypurat kanë prezantuar shumëllojshmëri më të madhe të qëndrimeve. Ndërkohë që *Dnevnik* dhe *Nova Makedonija* kanë treguar mbështetje të

⁵⁰

Telma, *Vesti 24* dhe *Alsat-M* e kanë informuar MVZ të OSBE/ODIHR-it që z. Ivanov nuk i është përgjigjur ftesave të tyre për pjesëmarrje në debate ose intervista individuale.

qartë për VMRO-DPMNE dhe kanë qenë kryesisht kritike ndaj LSDM-së, *Sloboden Pecat* ka qenë shumë kritik ndaj qeverisë dhe VMRO-DPMNE-së, duke e lavdëruar LSDM-në. Dy ditoret e monitoruara në gjuhën shqipe (*Koha* dhe *Lajm*) kanë qenë të përqendruara në aktivitetet e partive etnike shqiptare. Ndërkohë që *Koha* ka shfaqur mbështetje të qartë për BDI-në, *Lajm* ka qenë kritik ndaj saj.

XI. KUNDËRSHTIMET DHE PADITË

Kundërshtimet që kanë të bëjnë me zgjedhjet shqyrtohen nga KSHZ, gjykatat themelore, gjykatat e apelit, si dhe Gjykata Administrative. Kodi Zgjedhor ia jep të drejtën të gjithë kandidatëve të parashtrorjve kundërshtime në fazat e ndryshme të procesit, përfshirë edhe për regjistrimin e votuesve, regjistrimin e kandidatëve, fushatën dhe mediat, votimin dhe shpalljen e rezultateve. Votuesit kanë të drejtë të parashtrorjve kundërshtime vetëm për regjistrimin e votuesit dhe kur shkelen të drejtat e tyre në ditën e zgjedhjeve.⁵¹ Më tej, nuk mund të parashtrorhet ankesë ndaj disa vendimeve të trupave administrative, përfshirë edhe vendimet e KSHZ-së për shkeljet e rregullave të fushatës, vendimet e KSHPK-së për keqpërdorimin e resurseve shtetërore, si dhe ankesat kundër vendimeve të ESHR-së dhe KSHPK-së lidhur me shkeljet e financimit të fushatës.⁵²

KSHZ, ESHR dhe KSHPK nuk mund të shqiptojnë sanksione, por mund t'ia përcjellin lëndët gjykatave kompetente, duke iniciuar procedura penale ose për kundërvajtje. Nuk ka afate për përfundimin gjyqësor të rasteve të këtilla, që nuk e garanton ndreqjen e plotë efektive, si që kërkohet me Paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.

Procedura e ankesave do të përfitojë nga rishqyrtimi në nivel të përgjithshëm, për t'i eliminuar pavijueshmëritë, zbrazëtirat dhe mungesat, me qëllim që të sigurojë ndreqje efektive ligjore. Në veçanti, ligji duhet t'ia jep secilit votues të drejtën e kundërshtimit në çdo fazë të procesit zgjedhor; ta lejojë të drejtën e padisë gjyqësore kundër të gjitha vendimeve të KSHZ-së, ESHR-së dhe KSHPK-së, si dhe të përcaktojë afate të kuptueshme kohore për gjykatat, për vendim-marrje lidhur me këto raste.

Në KSHZ janë parashtruar tetë kundërshtime lidhur me aktivitetet e fushatës që janë realizuar para fillimit zyrtar të fushatës.⁵³ Në njërin rast, KSHZ e ka pranuar kundërshtimin e LSDM-së, ku është pretenduar që z. Ivanov është kyçur në fushatë të parakohshme më 14 mars; KSHZ ka ngritur procedurë të kundërvajtjes. Kundërshtimet tjera janë refuzuar me arsyetimin se ata të cilët kanë bërë fushatë ende nuk kanë qenë kandidatë të konfirmuar, së këndejmi rregullat e fushatës nuk vlejné për aktivitetet e tyre.

Janë parashtruar dy kundërshtime në KSHZ nga BDI dhe LSDM sipas dispozitës së re të Kodit Zgjedhor, ku partive politike i lejohet kundërshtimi i listës zgjedhore, pas përfundimit të

⁵¹ Shikoni edhe Paragrafin II.3.3.f të Kodit të praktikës së mire të çështjeve zgjedhore të Komisionit të Venedikut (2002).

⁵² Paragrafi 18.4 i Dokumentit të Moskës të OSBE-së (1991) përcakton që Shtetet-pjesëmarrëse të OSBE-së “do të përpiqen për sigurim të shqyrtimit gjyqësor të rregullativës dhe vendimeve të këtilla”.

⁵³ Tre janë parashtruar nga LSDM, një nga Aleanca për Maqedoni Pozitive (AMP) kundër VMRO-DPMNE-së. Katër janë parashtruar nga VMRO-DPMNE kundër LSDM-së.

periudhës së shikimit publik.⁵⁴ KSHZ ka kërkuar nga MPB që t'i hetojë kundërshtimet, por Ministria ka refuzuar, duke cekur se e ka përbushur detyrën e vet ligjore. Për pasojë, KSHZ i ka refuzuar ankesat. LSDM dhe BDI kanë parashtruar padi ndaj këtij vendimi në Gjykatën Administrative, e cila i ka refuzuar ato në bazë të dokumenteve të siguruar nga MPB, pa realizuar hetim të pavarur.

KSHZ ka refuzuar 791 aplikacione nga votuesit të cilët kanë kërkuar të përfshihen në listën zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në PDK Tiranë.⁵⁵ Prej tyre, 640 kanë parashtruar padi në Gjykatën Administrative, e cila e ka ndryshuar vendimin e KSHZ-së, duke vendosur që meqë KSHZ tashmë ka konfirmuar se këta votues i përbushin kriteret për të votuar jashtë vendit për zgjedhjet presidenciale, KSHZ nuk mund t'i përjashtojë ata nga listat zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Pas shikimit të listës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, BDI ka parashtruar kundërshtim në KSHZ, duke kërkuar që këta votues të mënjanohej nga lista zgjedhore, meqë janë banorë të përhershëm në Shqipëri. Ky kundërshtim është refuzuar nga KSHZ dhe Gjykata Administrative, në bazë të vendimeve paraprake. Edhe kundërshtimi i ngjashëm nga LSDM për mënjanimin e votuesve është refuzuar në dy nivelet.

Nuk ekziston asnjë dispozitë në Kodin Zgjedhor që e lejon parashtrimin e kundërshtimeve zyrtare në vendvotim gjatë ditës së votimit. Në vend të kësaj, përfaqësuesit e autorizuar duhet t'i shënojnë "vërejtjet" e tyre për parregullsitë në procesverbalet e KZ-ve pas përfundimit të votimit. Nëse KZ refuzon t'i përfshijë këto vërejtje në procesverbal, ato mund të regjistrohen në KKZ brenda pesë orëve pas nënshkrimit të procesverbalit. Përveç kësaj, përfaqësuesit e autorizuar duhet të parashtrorjnë kundërshtim zyrtar për çështjen e njëjtë në KSHZ, ku bëhet shqyrtimi dhe zgjidhja e lëndës. Në pajtim me rekomandimet paraprake të OSBE/ODIHR, Kodi Zgjedhor tashmë nuk e obligon KSHZ-në që ta inspektojë materialin votues vetëm në rastet kur ka të paktën dy kundërshtime për vendvotimin konkret.

Duhet të konsiderohet mundësia që t'i lejohet qytetarëve parashtrimi i kundërshtimeve në KZ, KKZ ose KSHZ në ditën e votimit, për të siguruar ndreqje efektive dhe me kohë.

Policia dhe prokuroria e kanë informuar MVZ të OSBE/ODIHR-it që kanë trajtuar rreth 90 lëndë të lidhura me zgjedhjet.⁵⁶ Disa prej bashkëbiseduesve të MVZ të OSBE/ODIHR-it kanë shprehur mungesë besimi në paanshmërinë e institucioneve përgjegjëse për trajtimin e shkeljeve që kanë të bëjnë me zgjedhjet – përfshirë këtu policinë, prokurorinë dhe gjyqësorin.

Për ta rritur besimin në sistemin e kundërshtimeve dhe padive, hetimi i kundërvajtjeve zgjedhore nga policia dhe prokuroria duhet të realizohet në mënyrë të paanshme dhe me kohë, me qëllim që të sigurohet procesi i drejtë.

⁵⁴ BDI e ka kërkuar shlyerjen e 453 qytetarëve – të gjithë të regjistruar për votim në Ambasadën në Tiranë. LSDM ka kundërshtuar 14.492 emra, duke pohuar që grupe votuesish që janë regjistruar ilegalisht në adresa të njëjta, kanë qenë në fakt të vdekur, me adresë të ndryshuar ose janë larguar nga vendi.

⁵⁵ Këta votues jetojnë në Pustec, Shqipëri dhe kanë shtetësi të dyfishtë.

⁵⁶ Këtu përfshihen 12 raste të shkatërrimit të zyrave të fushatës, 15 raste të shkeljes së heshtjes zgjedhore, si dhe raste të frikësimit të votuesve, votuesve të cilët i fotografojnë fletëvotimet e rrethuara, si dhe sulmet fizike. Disa raste i janë përcjellë prokurorit.

Kundërshtimet për keqpërdorimin e resurseve shtetërore dhe kërkesat për aprovimin e shpenzimeve të reja buxhetore parashtrohen në KSHPK. Sesionet e Komisionit nuk janë të hapura, vendimet nuk publikohen dhe ndaj tyre nuk mund të parashtrohen padi. KSHPK e ka informuar MVZ të OSBE/ODIHR-it që ka trajtuar rreth 1,200 kërkesa të institucioneve shtetërore për rritjen ose ndryshimin e dedikimit të shpenzimeve buxhetore pas shpalljes së zgjedhjeve (kryesisht lidhur me vazhdimin e kontratave të punësimit të nëpunësve publikë, gjë që ndalohet me ligj).

KSHPK duhet ta konsiderojë shqyrtimin e lëndëve në sesione të hapura brenda afateve të kuptueshme ligjore. Vendimet duhet të jenë publike dhe duhet të ekzistojë mundësia për kundërshtimin e tyre.

XII. VËZHGUESIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi zgjedhor e parasheh vëzhgimin e zgjedhjeve nga grupet qytetare dhe ndërkombëtare, si dhe përfaqësuesit e autorizuar të kandidatëve dhe partitë, në të gjitha nivelet e administrimit zgjedhor. Në KSHZ janë regjistruar gjithsej 326 vëzhgues ndërkombëtarë për rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, që pastaj është rritur në 610 për rrethin e dytë. Edhe grupet e vëzhguesve qytetarë kanë angazhuar një numër të madh të vëzhguesve për zgjedhjet më 27 prill. Dy organizatat joqeveritare (OJQ) me përvojë më të gjatë në vëzhgimin e zgjedhjeve në vend (MOST dhe CIVIL) kanë regjistruar 2.413, gjegjësisht 113 vëzhgues. Më 27 prill, MOST ka dërguar vëzhgues statikë në çdo të dytin vendvotim dhe ka bërë shpallje paralele të rezultateve zgjedhore. Përkitazi me rekomandimin e kaluar të OSBE/ODIHR, të gjithë vëzhguesit kanë pasur të drejtë të marrin kopje të procesverbaleve të rezultateve nga KKZ-të dhe KZ-të.

Asociacioni për aktivitete humanitare SINERGIJA ka regjistruar 5.050 vëzhgues, ndërsa Asociacioni i qytetarëve për demokratizim dhe ngritje të vetëdijes publike (VEPRO) nga Struga 2.321 vëzhgues. Shumë bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR-it i kanë shprehur shqetësimet që sipas mendimit të tyre, SINERGIJA ka qenë e lidhur me VMRO-DPMNE-në, ndërsa VEPRO me BDI-në dhe bojkotin e saj të zgjedhjeve presidenciale.⁵⁷

XIII. DITA E ZGJEDHJEVE

A. RRETHI I PARË

Votimi i hershëm më 12 prill është realizuar për votuesit në shtëpi, të burgosurit dhe personat e zhvendosur Brenda vendit. Në numrin e kufizuar të rasteve të vëzhguara nga MVZ i OSBE/ODIHR-it, procedurat janë respektuar dhe votimi ka rrjedhur në mënyrë të qetë dhe me rregull. Sa i përket votuesve që kanë votuar në shtëpi, disa KKZ e kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me kërkesat më të rrepta të përshtatshmërisë të përcaktuara nga vendimi i KSHZ-së, që ka rezultuar me disa aplikacionet të refuzuara nga KKZ-të. Në disa raste, fshehtësia e votës nuk është respektuar gjithmonë, meqë anëtarët e KZ-ve i kanë shënuar fletëvotimet e tyre. Gjatë votimit në burgje, MVZ i OSBE/ODIHR-it ka vërejtur disa raste kur të burgosurve me

⁵⁷

MVZ i OSBE/ODIHR-it i ka vërejtur vëzhguesit e VEPRO-së në vendvotimet në 13 prill – por jo edhe më 27 prill kur kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e autorizuar të BDI-së.

letërnjoftime të vlefshme ju është refuzuar e drejta e votimit, meqë nuk kanë qenë të përfshirë në listën zgjedhore.⁵⁸

Në ditën e zgjedhjeve, në numrin e kufizuar të vendvotimeve të vizituara nga MVZ i OSBE/ODIHR-it, procesi i votimit ka qenë i papenguar dhe i administruar në administruar në mënyrë efikase. Por, në një komunë, janë shënuar numër më i madh i parregullsive.⁵⁹ Votat janë numëruar në mënyrë profesionale dhe transparente; rezultatet janë publikuar me kohë. Dalja e votuesve ka qenë dukshëm më e ulët në zonat me shqiptarë etnikë⁶⁰ dhe shumë bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR-it ia kanë përshkruar këtë thirrjes së BDI-së që shqiptarët etnikë të mos votojnë në zgjedhjet presidenciale. Në sfondin e bojkotit të BDI-së, shënimi i gishtit të madh të votuesit me ngjyrë të zezë, në vend se me ngjyrë të padukshme është kritikuar nga disa bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR-it, meqë kështu ka qenë e qartë nëse personi ka votuar ose jo, që e ka rritur mundësinë për frikësimin e votuesve.

B. RRETHI I DYTË

Në përgjithësi, votimi i hershëm më 26 prill ka rrjedhur në mënyrë transparente dhe procedurat janë respektuar. Vlerësimi i përgjithshëm nga MVZ i OSBE/ODIHR-it ka qenë pozitiv për 88 prej 94 vëzhgimeve. Por, fshehtësia e votës nuk ka qenë e siguruar në 16 prej 95 rasteve. Si edhe në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, janë vërejtur disa raste ku të burgosurve me letërnjoftime të vlefshme nuk ju është lejuar të votojnë, meqë nuk kanë qenë të regjistruar në listën zgjedhore.

Dita e zgjedhjeve ka rrjedhur në mënyrë të papenguar dhe profesionale, ndonëse janë vërejtur disa parregullsi teknike gjatë ditës. MVZ i OSBE/ODIHR-it e ka vëzhguar procesin e hapjes në 104 vendvotime, votimin në 1070 vendvotime, ndërsa mbylljen dhe numërimin e votave në 99 vendvotime. Përfaqësuesit e autorizuar të partive politike dhe kandidatëve kanë qenë të pranishëm në 90% të vendvotimeve, ndërsa vëzhguesit qytetarë kanë qenë të pranishëm në 54% të vendvotimeve që janë vëzhguar gjatë hapjes, gjegjësisht 97% dhe 67% të vendvotimeve të vëzhguara gjatë votimit. Femrat kanë udhëhequr me 47% të vendvotimeve të vëzhguara dhe në përgjithësi, kanë qenë të përfaqësuara mirë në KZ-të. Dalja e votuesve ka qenë 63% për zgjedhjet parlamentare, gjegjësisht 54% për zgjedhjet presidenciale. Si edhe në rrethin e parë, dalja më e ulët për zgjedhjet presidenciale është shpjeguar me bojkotin dhe apelin e BDI-së drejtuar votuesve etnikë shqiptarë për të mos votuar në zgjedhjet presidenciale.

MVZ i OSBE/ODIHR-it ka pasur qasje të plotë dhe të pakufizuar gjatë hapjes së vendvotimeve; procesi është vlerësuar si pozitiv në 97% të vendvotimeve të vëzhguara. Megjithatë, janë vërejtur disa parregullsi procedurale, përfshirë edhe rastet kur vëzhguesve nuk ju është treguar që kutitë e votimit janë të zbrazëta (15 raste), si dhe mosplotësimi i procesverbaleve të hapjes para hapjes së vendvotimeve (14 raste).

⁵⁸ Pjesa 1.2.iv i Kodit të praktikës së mire të çështjeve zgjedhore të Komisionit të Venedikut (2002) rekomandon që “duhet të ketë procedurë administrative – që i nënshtrohet kontrollit gjyqësor – ose ndonjë procedurë gjyqësore me të cilën lejohet regjistrimi i votuesit që nuk është regjistruar”.

⁵⁹ Në Shuto Orizare, ku përveç kësaj, është raportuar për një grindje mes ish-deputetes Radmila Shekerinska (nënkryetare e LSDM-së) dhe ish-deputetit Amdi Bajram (Kryetar i Lidhjes së Romëve të Maqedonisë).

⁶⁰ Në Komunën Çair, dalja ka qenë 20.2%, ndërsa në Tetovë ka qenë 24.8%. Në vendvotimin 0815 në Komunën Kërçovë nuk ka votuar asnjë prej 844 votuesve të regjistruar.

Në vlerësimin e përgjithshëm pozitiv, procesi është vlerësuar si i mirë ose shumë i mirë në 96% të vëzhgimeve, ndërsa transparent në 97%. Puna e KZ-ve dhe njohja e procedurave të votimit është vlerësuar pozitivisht në 95% të vëzhgimeve. Megjithatë, shumë KZ nuk e kanë respektuar udhëzimin e KSHZ-së për t'i këshilluar votuesit që mund të votojnë për dy zgjedhjet, ose vetëm për njërin proces. Në zonat etnike shqiptare, anëtarët e KZ-ve i kanë dekurajuar votuesit nga marrja e fletëvotimit presidencial, në pajtim me thirrjen e BDI-së për bojkotimin e zgjedhjeve, që e ngrit pyetjen e paanshmërisë së administratës zgjedhore.⁶¹ Në rajonet etnike maqedonase, votuesve i janë dhënë automatikisht dy fletëvotimet. Para ditës së votimeve, KSHZ ka lëshuar një udhëzim me të cilin është ndryshuar kërkesa ligjore për shënimin e gishtit të madh të dorës së djathtë, me atë të dorës së majtë, meqë shumë votues ende kanë pasur gjurmë të ngjyrës së rrethit të parë në dorën e tyre të djathtë.

Parregullsia më e shpeshtë ka qenë votimi në grupe, që është vëzhguar në rreth 8% të vendvotimeve. OSBE/ODIHR ka rekomanduar paraprakisht që KSHZ duhet të sigurojë më tepër informata dhe edukim për votuesit mbi votimin në grupe, si dhe fshehtësinë e votës. Vëzhguesit e MVZ të OSBE/ODIHR-it kanë raportuar për grupe të cilat kanë qëndruar jashtë shumë vendvotimeve dhe në shumë raste, duke i shënuar emrat e votuesve që kanë votuar, gjë që krijon klimë frikësuese rreth vendvotimeve ku është vërejtur kjo.

Vlerësimi i përgjithshëm i numërimit ka qenë pozitiv në 84 prej 94 vëzhgimeve. Ndonëse në 17 raste janë raportuar parregullsi procedurale, ato nuk e kanë ndikuar realizimin e përgjithshëm të zgjedhjeve.⁶² Procesi ka qenë transparent dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë pasur qasje të pakufizuar në numërim në të gjitha vendvotimet. Në 8 vendvotime, disa anëtarë të KZ-ve kanë refuzuar ta nënshkruajnë procesverbalin. Më tej, në 37 vendvotime, KZ-të nuk e kanë shpallur publikisht ekzemplarin e procesverbalit të rezultateve, si që kërkohet me ligj dhe kjo e ka penguar kriterin e rëndësishëm të transparencës.

C. SHPALLJA E REZULTATEVE

Gjatë zgjedhjeve të 13 prillit, procesi i shpalljes ka qenë i organizuar mirë në përgjithësi, në ato pak KKZ të vizituara nga MVZ i OSBE/ODIHR-it. Ndonëse ka pasur disa mospërputhje të vogla në procesverbalet e rezultateve të KZ-ve, ato kanë qenë gabime teknike të cilat janë përmirësuar nga KKZ-të pas verifikimit të materialeve zgjedhore.

Më 27 prill, MVZ i OSBE/ODIHR-it e ka vëzhguar shpalljen në 76 prej 80 KKZ-ve dhe e ka vlerësuar procesin si pozitiv në të gjitha rastet, përveç njërit. Janë vërejtur mospërputhje serioze në procesverbalet e KZ-ve në 11 vëzhgime, por ato janë përmirësuar nga KKZ-të pas verifikimit të materialeve zgjedhore. Përfaqësuesit e autorizuar të partive politike dhe të kandidatëve kanë qenë në 99% të KKZ-ve të vëzhguara, ndërsa vëzhguesit qytetarë kanë qenë të pranishëm në 93% të shpalljeve të vëzhguara.

KSHZ e ka filluar shpalljen e rezultateve në ueb faqe, paralelisht me pranimin e tyre nga KKZ-

⁶¹ Paragrafi 20 i Komentit gjeneral nr. 25 të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut (UNHCR) i vitit 1996 parasheh që “duhet të formohet një trup i pavarur zgjedhor, për mbikëqyrjen e procesit zgjedhor dhe për sigurimin që ky proces është realizuar në mënyrë të drejtë dhe paanshme”.

⁶² Për shembull, sipas udhëzimeve të KSHZ-së, KZ-të është dashur të hedhin short për ta zgjedhor anëtarin e cili i nxjerr fletëvotimet nga kutia e votimit. Në shumë raste, ky vendim është marrë nga anëtarët e KZ-ve.

të në natën pas zgjedhjeve, të kategorizuara sipas njësive zgjedhore dhe vendotimeve, në pajtim me rekomandimin paraprak të OSBE/ODIHR-it. Kjo ka qenë një masë pozitive për rritjen e transparencës.⁶³

Dalja e votuesve për zgjedhjet presidenciale ka qenë 48%, gjegjësisht 54%. Z. Ivanov e ka fituar shumicën në rrethin e dytë me 55%, ndërsa z. Pendarovski ka pasur 41% të votave. Dalja për zgjedhjet parlamentare ka qenë 62%. Prej 123 ulëseve në Parlament, VMRO-DPMNE ka fituar 61, LSDM 34, BDI 19, PDSH 7, GROM 1, ndërsa RDK 1.

Menjëherë pas përfundimit të votimit, lideri i partisë LSDM, Zoran Zaev, ka shpallur që partia dhe koalicioni i saj nuk do t'i njohin rezultatet e zgjedhjeve presidenciale dhe atyre parlamentare, duke kërkuar zgjedhje të reja dhe formimin e një qeverie autokrate.⁶⁴ Këshilli drejtues i LSDM-së më pas ka konfirmuar që partia dhe partnerët e koalicionit nuk do t'i marrin mandatet e tyre në parlamentin e ri.⁶⁵

Më 2 maj, KSHZ e ka konfirmuar zyrtarisht rizgjedhjen e Presidentit aktual. Anëtarët e KSHZ-së të propozuar nga BDI dhe dy të LSDM-së nuk kanë marrë pjesë në këtë mbledhje. KSHZ i ka shpallur rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare më 6 maj dhe i ka dhënë mandatet më 7 maj. Kandidatët e LSDM-së nuk i kanë pranuar mandatet e tyre.

XIV. KUNDËRSHTIMET DHE ANKESAT PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE

Nuk janë parashtruar kundërshtime pas zgjedhjeve të 13 prillit. Lidhur me votimin më 27 prill, janë regjistruar vërejtjet e parashtruara nga përfaqësuesit e autorizuar të LSDM-së në KZ dhe KKZ-të, për parregullsi në rreth 260 vendotime në ditën e votimit.⁶⁶ Në disa raste, përfaqësuesve partiakë nuk i është lejuar regjistrimi i vërejtjeve në ditarin e KZ-ve, ndërsa ka ndodhur që të lejohen për shënim vetëm në ditarin dhe jo në procesverbalin e KZ-ve. Në raste tjera, KKZ-të nuk e kanë pranuar regjistrimin e vërejtjeve që janë refuzuar paraprakisht nga KZ-të.

KSHZ ka pranuar 12 kundërshtime pas ditës së zgjedhjeve dhe i ka refuzuar të gjitha.⁶⁷ Dhjetë prej tyre janë ankuar në Gjykatën Administrative, e cila i ka mbështetur vendimet e KSHZ-ë. Kundërshtimet e kanë kërkuar anulimin e votimit në 71 vendotime në bazë të shkeljes së fshehtësisë së votës, votimit në grup, votimit të ndërmjetësuar, fushatës në ditën e zgjedhjeve, si

⁶³ Deri në orën 10:00 më 28 prill, në ueb-faqen e KSHZ-së kanë qenë të publikuara rezultatet e të gjitha vendotimeve, përfshirë edhe rezultatet e votimit jashtë vendit.

⁶⁴ Z. Zaev ka deklaruar që votuesit nuk kanë mundur të votojnë lirshëm dhe e ka akuzuar VMRO-DPMNE-në për "keqpërdorim të tërë sistemit, me kërcënime, shantazhe dhe blerje masive të votave".

⁶⁵ Më tej, RDK ka shpallur që nuk do t'i njohë rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, ndërsa BDI që nuk do t'i njohin rezultatet e votës për tre mandatet e diasporës.

⁶⁶ Këtu përfshihen rreth 58 raste kur votuesit janë regjistruar nga vëzhguesit partiakë, 51 raste të fushatës brenda ose para vendvotimit, 18 raste të votimit publik ose prezantimit të fletëvotimit, 17 raste të heqjes së raportuar të ngjyrës, 13 raste të votimit në grup 12 raste kur adresat në letërnjoftim nuk janë përputhur me adresat e listës zgjedhore, 12 raste të votuesve të regjistruar vetëm në një listë (presidenciale ose parlamentare), 8 raste të votuesve që e kanë fotografuar fletëvotimin e tyre, si dhe 7 raste të leximit publik të personave që kanë votuar.

⁶⁷ 6 nga BDI, 4 nga PDSH dhe 2 nga GROM – shumica janë refuzuar meqë nuk janë regjistruar vërejtje në procesverbalet e KZ-ve.

dhe për presion të ushtruar mbi votuesit. LSDM nuk ka parashtruar asnjë kundërshtim formal lidhur me vërejtjet e shënuara në procesverbalet e KZ-ve, si pasojë e vendimit për mosnjohjen e rezultateve të zgjedhjeve presidenciale ose parlamentare.

XV. REKOMANDIMET

Rekomandimet në vijim, si që janë cekur në tekstin e sipërm, ofrohen në aspekt të përforsimit të realizimit të zgjedhjeve dhe mbështetjes së përpjekjeve për ngritjen e tyre të plotë sipas përkushtimeve të OSBE-së dhe obligimeve tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Këto rekomandime duhet të lexohen së bashku me rekomandimet e kaluara të OSBE/ODIHR-it, që presin të trajtohen. OSBE/ODIHR mbetet i gatshëm t'i ndihmojë autoriteteve të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në përmirësimin e mëtejshëm të procesit zgjedhor, si dhe trajtimit të rekomandimeve që jepen në këtë dhe raportet e kaluara.⁶⁸

A. REKOMANDIMET ME PRIORITET

1. Autoritetet duhet të tregojnë më tepër vullnet politik për ta siguruar ndarjen e mjaftueshme mes Shtetit dhe aktiviteteve partiake, si dhe të ndërmarrin hapa të fuqishëm për ndalimin e çfarëdo forme të presionit mbi votuesit. Zyrtarët e lartë publikë mund të japin deklarata të qarta dhe të lëshojnë instruksione me shkrim që nuk do të tolerohet asnjë presion mbi nëpunësit publike, si dhe që asnjë i punësuar ose qytetar nuk duhet të frikohet për vendin e punës ose për ndihmën sociale nëse mbështetë ose nuk mbështetë ndonjë parti politike ose kandidat të caktuar. Të gjitha rastet dhe pohimet e presionit dhe frikësimit duhet të hetohen dhe ndiqen detajisht nga institucionet kompetente.
2. Rekomandohet mënjanimi i kërkesës së periudhës së banimit për kandidaturë presidenciale.
3. Nevojitet rishqyrtimi i sistemit aktual të ndarjes së mandateve në njësitë zgjedhore jashtë vendit, për të siguruar që çdo deputet përfaqëson numër të ngjashëm të votuesve të regjistruar dhe për ta respektuar parimin e të drejtës së barabartë të votës.
4. Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet dhe t'i trajtojë zbrazëtirat dhe dykuptimësitë e identifikuar në këtë raport, si dhe në raportet paraprake të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venedikut. Reforma duhet të jetë inkluzive dhe të përmbyllet bukur para zgjedhjeve të ardhshme.
5. KSHZ duhet t'i zgjidhë të gjitha kundërshtimet dhe ankesat me paanshmëri, duke qenë e lirë nga konsideratat politike. Ligji duhet të interpretohet, implementohet dhe zbatohet sipas qëllimit të ligjit dhe për më tepër, KSHZ duhet ta konsiderojë krijimin e një seksioni për çështje juridike, si që kërkohet me Kodin Zgjedhor.

⁶⁸ Në Paragrafin të Dokumentit të Stambollit të OSBE-së (1990), Shtetet-pjesëmarrëse janë përkushtuar për "përcjelljen gjegjëse të vlerësimit zgjedhor dhe rekomandimeve të ODIHR-it".

6. Procedura e ankesave do të përfitojë nga rishqyrtimi në nivel të përgjithshëm, për t'i eliminuar pavijueshmëritë, zbrazëtitat dhe mungesat, me qëllim që të sigurojë ndreqje efektive ligjore. Në veçanti, ligji duhet t'ia jep secilit votues të drejtën e kundërshtimit në çdo fazë të procesit zgjedhor; ta lejojë të drejtën e padisë gjyqësore kundër të gjitha vendimeve të KSHZ-së, ESHR-së dhe KSHPK-së, si dhe të përcaktojë afate të kuptueshme kohore për gjykatat, për vendim-marrje lidhur me këto raste.

B. REKOMANDIMET TJERA

Korniza ligjore

7. Garancitë ekzistuese ligjore në Kodin Zgjedhor duhet të interpretohen në mënyrë që i parandalon konfliktet e mundshme të interesit mes posteve qeveritare të cilat kërkojnë neutralitet, si dhe kandidatëve që kërkojnë avantazh politik nga ana tjetër. Dispozitat e këtilla duhet të zgjerohen për t'i përfshirë edhe mekanizmat e zbatimit.

Sistemi zgjedhor

8. Kërkesa për daljen e votuesve prej 40% në rrethin e dytë mund të rikonsiderohet dhe mënjanohet, meqë krijon mundësi për shkaktimin e cikleve të zgjedhjeve të dështuara.

Administrata zgjedhore

9. Duhet të konsiderohet përforcimi i resurseve të sekretariatit të KSHZ-së, për ta siguruar kapacitetin e mjaftueshëm për realizimin e detyrave në mënyrë efikase.

Regjistrimi i votuesve

10. Kodi Zgjedhor duhet të rishqyrtohet për të siguruar ndarje të qartë të përgjegjësive mes MPB-së dhe KSHZ-së lidhur me kundërshtimet e listës zgjedhore. Autoritetet duhet të obligohen me ligj për hetimin e kundërshtimeve të këtilla brenda një afati të kuptueshëm kohor.
11. Së bashku me sigurimin e respektimit të kërkesave të rrepta për kualifikim për metodat alternative të votimit, duhet të konsiderohet thjeshtimi i procedurave për t'i mundësuar votuesve të cilët qëndrojnë në spitale, votuesve në shtëpi dhe tjerëve me lëvizshmëri të kufizuar për ta ushtruar të drejtën e tyre të votimit – pa pengesa të paarsyeshme.
12. Duhet të konsiderohet rishqyrtimi i procedurave të krijimit dhe mbajtjes së listave zgjedhore. Procedurat e qarta, të koordinuara dhe transparente për të gjitha institucionet e përfshira në azhurnimin e listave zgjedhore do ta rrisin saktësinë e tyre dhe mund të kontribuojnë në besimin publik.

Regjistrimi i kandidatëve

13. Mund të konsiderohet ofrimi i metodave alternative për mbledhjen e nënshkrimeve, për ta ulur potencialin për frikësim. Në vijim të rekomandimeve paraprake, mund të rishqyrtohet kufizimi që qytetarët të nënshkruhet për vetëm një kandidat.

Fushata zgjedhore

14. Dispozitat mbi fushatën duhet të zbatohen në mënyrë që krijojnë mundësi të barabarta për garuesit.

Financimi i fushatës

15. Fushata nga palët e treta në procesin zgjedhor mund të jetë temë e legjislacionit për financimin e fushatës.
16. Për ta rritur transparencën dhe llogaridhënien, mund të konsiderohet kategorizimi sipas zërave për të hyrat dhe të dalat në raportet e financimit të fushatës, së bashku me ekstraktet e plota bankare.
17. Mund të konsiderohet që ESHR-së t'i jepet autorizim hetues, për ta mundësuar kontrollimin e plotë të financimit të fushatës, përfshirë edhe të drejtën për kërkimin e dokumentacionit plotësues dhe dëshmime nga partitë, me qëllim që të shqyrtohet çdo kundërvajtje e mundshme.
18. Ligji duhet të parasheh sanksione proporcionale dhe shkëshillues për mosparashtrimin e raporteve për financimin e fushatës dhe kundërvajtjeve tjera. Përveç kësaj, mund të konsiderohet edhe ndryshimi i legjislativës për t'i lejuar të gjitha palëve të kyçura në zgjedhje të parashtrajnë kundërshtime për shkeljet e financimit të fushatës.

Media

19. Rekomandohet që anëtarët e ASHMAA-së të kenë përvojë paraprake me mediat dhe të mos jenë para se gjithash emëtime politike.
20. Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet për t'i dhënë të gjithë pjesëmarrësve zgjedhorë qasje pa diskriminim në transmetuesin publik.
21. ASHMAA duhet të iniciojë procedura kundërvajtëse lidhur me shkeljet e identifikuar me kohë, për ta rritur besimin publik dhe për t'i siguruar ndreqje efektive palëve të cilat kundërshtojnë. Sanksionet duhet të definohen qartë dhe të përkasin me peshën e shkeljes.
22. Mediat e transmetuara – veçanërisht ato publike – duhet të bëjnë më shumë përpjekje për ta bërë dallimin e qartë mes aktiviteteve zyrtare qeveritare të kandidatëve dhe shfaqjeve në fushatë, nga ana tjetër.

Ankimi

23. Për ta rritur besimin në sistemin e kundërshtimeve dhe padive, hetimi i kundërvajtjeve zgjedhore nga policia dhe prokuroria duhet të realizohen në mënyrë të paanshme dhe me kohë, me qëllim që të sigurohet procesi i drejtë.

24. KSHPK duhet ta konsiderojë shqyrtimin e lëndëve në sesione të hapura brenda afateve të kuptueshme ligjore. Vendimet duhet të jenë publike dhe duhet të ekzistojë mundësia për kundërshtimin e tyre.
25. Duhet të konsiderohet mundësia që t'i lejohet qytetarëve parashtrimi i kundërshtimeve në KZ, KKZ ose KSHZ në ditën e votimit, për të siguruar ndreqje efektive dhe me kohë.

SHTOJCË: REZULTATET PËRFUNDIMTARE⁶⁹

Rezultatet e zgjedhjeve presidenciale				
Gjithsej numri i votuesve të regjistruar	1,779,572			
Kandidati	Rrethi 1		Rrethi 2	
	votat	%	votat	%
Gjorge Ivanov	449,442	51.69	534,910	55.28
Iljaz Halimi	38,966	4.48	398,077	41.14
Stevo Pendarovski	326,164	37.51	–	–
Zoran Popovski	31,368	3.61	–	–
Gjithsej vota të pavlefshme	23,667	2.72	34,707	3.59
Gjithsej vota	869,547	48.86	967,694	54.38
Rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare				
Gjithsej numri i votuesve të regjistruar	1,780,128			
Partitë/koalicionet	votat	%	mandatet	
Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë	283,955	25.34	34	
Partia Demokratike Shqiptare	66,393	5.92	7	
Koalicioni Dinjiteti për Maqedoni	9,265	0.83	0	
Bashkimi Demokratik për Integrim	153,646	13.71	19	
Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas	481,615	42.9	61	
Rilindja Demokratike Kombëtare	17,783	1.59	1	
Lëvizja Popullore për Maqedoni	1,925	0.17	0	
Koalicioni GROM	31,610	2.82	1	
Koalicioni për Maqedoni Pozitive	10,566	0.94	0	
Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Popullore	16,772	1.50	0	
Partia Socialdemokrate e Maqedonisë	4,700	0.42	0	
Partia për ndryshime ekonomike 21	1,281	0.11	0	
Partia për Prosperitet Demokratik	385	0.03	0	
Partia për Ardhmëri Evropiane	3,194	0.28%	0	
Gjithsej vota të pavlefshme	37,654	3.35%	–	
Gjithsej vota	1,120,744	62.96%	–	

⁶⁹ Të dhënat sipas rezultateve përfundimtare të publikuara në: www.sec.mk.

RRETH OSBE/ODIHR-IT

Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që i ndihmon Shtetet pjesëmarrëse “të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të respektojnë shtetin e së drejtës, të promovojnë parimet e demokracisë dhe (...) të ndërtojnë, të forcojnë dhe të mbrojnë institucionet demokratike, si dhe ta promovojnë tolerancën në të gjitha nivelet e shoqërisë” (Dokumenti i Helsinkit i vitit 1992). Kjo pjesë njihet edhe si dimension i njerëzor i OSBE-së.

OSBE/ODIHR-i, me seli në Varshavë (Poloni), është themeluar në Samitin e Parisit në vitin 1990 si Zyra për Zgjedhje të Lira, që filloi të funksionojë në maj të vitit 1991. Një vit më vonë u ndryshua emri i Zyrës, për ta pasqyruar mandatin e zgjeruar ku përfshihen të drejtat e njeriut dhe demokratizimi. Sot, organizata punëson më tepër se 130 persona.

OSBE/ODIHR-i është institucioni kryesor në Evropë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Çdo vit, ai e koordinon dhe organizon dërgimin e mijëra vëzhguesve për të vlerësuar nëse zgjedhjet në rajonin e OSBE-së janë zhvilluar në përputhje me përkushtimet e OSBE-së, standardet tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe legjislacionin nacional. Metodologjia e saj e posaçme siguron vështrim në thellësi të tërë procesit zgjedhor. Përmes projekteve për mbështetje, OSBE/ODIHR i ndihmon Shtetet pjesëmarrëse të përmirësojnë kornizën e tyre zgjedhore.

Aktivitetet e Zyrës për **demokratizim** e përfshijnë: sundimin e ligjit, mbështetjen legjislative, qeverisjen demokratike, emigracionin dhe lirinë e lëvizjes, si dhe barazinë gjinore. OSBE/ODIHR zbaton një numër programesh të mbështetjes së përshtatur çdo vit, me synim të zhvillimit të strukturave demokratike.

Më tej, OSBE/ODIHR-i ndihmon Shtetet pjesëmarrëse në përmbushjen e detyrimeve të tyre për promovimin dhe mbrojtjen e **të drejtave të njeriut** dhe liritë themelore, në përputhje me përkushtimet e OSBE-së për dimensionin njerëzor. Kjo arrihet duke punuar me një sërë partnerësh për nxitjen e bashkëpunimit, krijimin e kapaciteteve dhe ofrimin e ekspertizës në fusha tematike, duke i përfshirë të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut për personat e trafikuar, edukimin dhe trajnimin për të drejtat e njeriut, monitorimin e të drejtave të njeriut dhe raportimin mbi to, si dhe garantimin e të drejtave dhe sigurisë së femrave.

Në fushën e **tolerancës** dhe **mos-diskriminimit**, OSBE/ODIHR i jep mbështetje Shteteve pjesëmarrëse për përforcimin e përgjigjeve të tyre ndaj krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe formave të tjera të jo-tolerancës. Aktivitetet e OSBE/ODIHR-it në këto fusha përqendrohen në tematikat e cekura në vijim: legjislacioni, trajnimi në fushat e zbatimit të ligjit, monitorimi, raportimi dhe ndjekja e përgjigjeve që u jepet krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja, si edhe aktivitetet edukative për të nxitur tolerancën, respektin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.

OSBE/ODIHR-i siguron këshillim për Shtetet pjesëmarrëse mbi politikat e tyre për komunitetet **rome dhe sinti**. Zyra e promovon ngritjen e kapaciteteve dhe lidhjeve mes komuniteteve rome dhe sinti, si dhe e inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve romë dhe sinti në organet e politikë-bërjes.

Të gjitha veprimtaritë e ODIHR-it zhvillohen në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, institucionet dhe operacionet e OSBE-së në terren, por gjithashtu edhe me organizatat tjera ndërkombëtare.

Më tepër informacione mund të gjeni në ueb-faqen e ODIHR-it (www.osce.org/odihp).